



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 142, gusht 2015
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Librat e mi janë jeta ime

ME LAZER STANIN, NË NJË BISEDË PËR PROCESIN E SHKRIMIT DHE LUMTURINË



Në një kohë kur kritika gjithnjë e më tepër po flet për një largim të vëmendjes nga tregimi, Lazer Stani i përket asaj sere shkrimtarësh që nuk duan të largohen prej tij. Publicistika duket se ashtu siç shprehej Buzati, e bën më të fortë tregimtarin. Ajo të bën të mos kesh frikë nga historitë e tua e t'i sjellësh ato si në jetë. Por si është procesi i të shkruarit për Stanin, cilat janë ritualet që i japin jetë shkrimtarit tek ai ...

SI NDODH TE JU PROCESI I TË SHKRUARIT? KENI NJË RITUAL TUAJIN?

Ndodh, jo gjithmonë, por ndodh. Kjo do të ishte përgjigja më e saktë. Nuk ka një vend të caktuar, një kohë të caktuar, një stinë të caktuar. Ndodh papritur, pa të lajmëruar, siç ndodh një histori dashurie. Mbaj mend se tregimin e parë e kam shkruar në një natë ankthi, në një natë të vetmuar, në ca fletë që rastësisht u ndodhën në tryezë, ca fletë të çuditshme me ngjyrën e thasëve të çimentos, që nuk e di se cili prodhues mendjekrisur i kishte shpikur. Tregimi mbante titullin "Emri im i bukur", një tregim që s'e kam përfshirë në asnjë prej librave. Gjithsesi të shkruarit, filloi t'i shndërronte orët e vetmisë në orë dashurie. Të shkruarit të shpie gjithmonë një realitet tjetër...

2

MJESHTRI I MAGJISË SKENIKE DHE TELEVIZIVE, OSMAN MULA RESPEKTOHET DHE NDEROHET NGA SHKODRA

"MJESHTRI I MADH" OSMAN MULA GJITHNJË DIALOGON ME KOHËN PËRMES VLERASH KONKURUESE NË MENDIM, MUZIKË, INTERPRETIM, REGJISURË, KULTURËN KOMBËTARE, TRADITËN DHE NË VEÇANTI STILIN SHKODRAN



5

Forcën dhe inspirimin e gjejë tek populli im i mrekullueshëm...!

Bashkëbisedim, me publicistin dhe gazetarin Florim Zeqa Dikur ekzistonte grupi muzikor "Na bashkoi kënga popullore" (nuk kam njohuri a ekziston ende!?), një emër shumë karakteristike, që është në të njëjtën kohë me bashkëbiseduesin e këtij bashkëbisedimi, por jo me këngën! Mua, me zotin Florim Zeqa na njohu e bashkoi aktiviteti, gazetaria, publicistika, mësuesia, ... Me aktivitetin, u njohëm për herë të parë në takimin e organizuar nga Ministria e Diasporës me bashkatdhetarët rreth projekt Strategjisë për Diasporën, mbajtur në Treviso... Me gazetari e publicistikë u ndeshëm në faqet e gazetave, faqeve informative, për mes komenteve, reportazheve, shkrimeve gazetareske, e te tjera.

8

Frederik Rreshpja, poetin, që e mbyllin jetën në një libër...



Frederik Rreshpja, në pamje të parë, mund të duket një poet jashtë rrjedhave. Ky mendim krijohet duke parë botimet e dy dekadave të fundit, mirëpo, po t'u hedhësh një sy librave të rinisë së tij, kuptohet se sa e rëndësishme ka qenë për këtë poet krijimtaria poetike e Ismail Kadaresë, edhe pse tregonte një talent të veçantë në shumë drejtime.

Duhet thënë se shumë motive dhe qasje ndaj tyre të kujtojnë poetitë dhe qasjet poetike të atij që shihej si poeti më i suksesshëm i kohës. Në mendimin zyrtar të viteve '60-të, kohë kur u shfaq së pari poeti Rreshpja, sukcesi shihej te tematika, diçka që ilustron me emrat e Lazar Siliqit, Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit, Fatos Arapit e te tjere. Si poet i ri që kërkon suksesin, Rreshpja bëhet pjesë e këtij modeli, duke ia arritur qëllimit që i kishte vënë vetes, sepse poema "Topi fushor" hyn në antologjinë më të rëndësishme zyrtare të kohës, pa botuar më parë ndonjë përmbledhje poezish më vete. Në përmbledhjen e parë (1968), këtë "haraç" do ta gjejmë te poetitë e poemat për partizanin, heronjtë e punës socialiste, aksionistët, lapidarët, ushtarët e revolucionit, ndërsa në përmbledhjen e dytë (1973) do ta gjejmë te poetitë e poemat për komisararin, hidrocentralet, 8 Nëntorin, 1 Majin e te tjere, gjithmonë duke pasur parasysh se, me anën e realizmit socialist, poezia shqipe po njihete në të ardhmen futuriste dhe postfuturiste, sidomos nga ndikimi majakovskian.

12

MIRËNJOHJE ATYRE QË KONTRIBOJNË NË RRITJEN E VLERAVE NACIONALE ...

Pak dite me pare ishim te ftuar ne një veprimtari te organizuar nga shoqata Atdhetare "Malësia". Një mjedis tepër miqësor dhe komod për te vlerësuar disa personalitete te artit dhe kulturës, te cilët me punën e tyre kane bere, te meritojnë respektin dhe mirënjohjen e te gjithë shoqërisë. E veçanta ishte se, ata vinin nga zona te ndryshme, por edhe nga vende te ndryshme ku jetojnë shqiptaret.

Te pranishëm ne këtë veprimtari ishin. Mjeshtri Fadil Kraja, Nën-prefekta e Malësisë se Madhe, zonja Taze Lohja; Kryetari i Shoqërisë se Shkrimtarëve ne Shkodër, shkrimtari Skënder Temali, Kritiku letrare Kadri Ujka, Kryetari i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Ndue Sanaj; kryetari i Shoqatës "Malësia e Madhe-Nderi i Kombit", Sytiku Ndreca e mjaft te tjerë artist, ...

9


Librat e mi janë jeta ime

ME LAZER STANIN, NË NJË BISEDË PËR PROCESIN E SHKRIMIT DHE LUMTURINË

Në një kohë kur kritika gjithnjë e më tepër po flet për një largim të vëmendjes nga tregimi, Lazer Stani i përket asaj sërë shkrimtarësh që nuk duan të largohen prej tij. Publicistika duket se ashtu siç shprehej Buzati, e bën më të fortë tregimtarin. Ajo të bën të mos kesh frikë nga historitë e tua e t'i sjellësh ato si në jetë. Por si është procesi i të shkruarit për Stanin, cilat janë ritualet që i japin jetë shkrimtarit tek ai ...

SI NDODH TE JU PROCESI I TË SHKRUARIT? KENI NJË RITUAL TUAJIN?

Ndodh, jo gjithmonë, por ndodh. Kjo do të ishte përgjigjja më e saktë. Nuk ka një vend të caktuar, një kohë të caktuar, një stinë të caktuar. Ndodh papritur, pa të lajmëruar, siç ndodh një histori dashurie. Mbaj mend se tregimin e parë e kam shkruar në një natë ankthi, në një natë të vetmuar, në ca fletë që rastësisht u ndodhën në tryezë, ca fletë të çuditshme me ngjyrën e thasëve të çimentos, që nuk e di se cili prodhues mendjekrisur i kishte shpikur. Tregimi mbante titullin "Emri im i bukur", një tregim që s'e kam përfshirë në asnjë prej librave. Gjithsesi të shkruarit, filloi t'i shndërronte orët e vetmisë në orë pasioni, në orë dashurie. Të shkruarit të shpie gjithmonë një realitet tjetër, paralel me realitetin në të cilin jetojmë: më sublim, më të përkryer, më afër ëndrrës. Të shkruarit është një arratisje e vazhdueshme nga realiteti, një ikje e pandalshme, një shtegtim në hapësirat e imagjinatës. Është një akt frike dhe guximi njëkohësisht, një akt dëshpërimi dhe besimi. Të shkruarit, në njëfarë mënyre, na shpëton nga kompleksi i hiçit, i asgjësë, është një përpjekje, ndoshta e kotë, për të përballuar sfidën shpartalluese të ekzistencës. Por dhe vetë procesi i të shkruarit (fjalën shkrimtari e urrej) mund të kategorizohet në të shkruarit nga pasioni dhe në të shkruarit, si ves. Kur të shkruarit bëhet ves, atëherë akti i krijimit degradohet, humbet fuqinë, sterilizohet nga ndjenjat, emocionet, shpirti, misteri. Por njeriu, shkrimtari, e ka të vështirë t'i identifikojë veset e tij. Gjithsesi nga eksperiencia më e freskët, në procesin e shkrimit të disa prej



tregimeve të librit të fundit, kam pasur shkundje të forta emocionale, si për shembull, gjatë procesit të shkrimit të tregimeve "Kohë për nuse", "Pianisti", apo "Daiza Zaharia". Nëse do të ishte e mundur, do të shkruaja duke ecur, diku në një rrugicë pylli të shkretë, a në një korridor të zbrazët pa fund. Gjithnjë para se të ulem për të shkruar, qëndroj në këmbë duke ardhur rrotull një copë herë; ndez një cigare, harrohem. Krijon një kontradiktë qëndrimi ulur para kompjuterit dhe krijimi vetë si akt i gjallë, në lëvizje, në shkundje. Gjithsesi, nuk ke mënyrë tjetër për të shkruar veçse i ulur në tryezë, i gozhuar aty.

I KTHEHENI SHPESH NJË DORËSHKRIMI?

Gjithmonë. Shumë herë. Në fillimet e mia, i shkruaja tregimet me dorë, pastaj i shtypja në makinë shkrimi. E shikoja se gjatë procesit të shtypjes, gjithçka transformohej dhe tregimi që dilte nga makina e shkrimit nuk ishte më i njëjti me atë që kisha shkruar me dorë. Ishte një tregim tjetër, i ri. Edhe tani nuk mund të ulëm e të radhis në kompjuter një tregim timin të shkruar vite më parë. Sepse instinktivisht, në mënyrë të pavetëdijshme, do ta shndërroj në diçka tjetër, në mos të tërin, të paktën pjesërisht. Duket se procesi i krijimit, është një proces i hapur, pafund, ndaj autori kurrë nuk është i kënaqur. Edhe ato momente deliri, që të pushtojnë pas përfundimit të një tregimi apo të një fragmenti që të pëlqen veçanërisht, zbehen shpejt dhe ti ndien një bosh ng-

jethës. Edhe tregimeve të librit të fundit u jam rikthyer disa herë, ka ndodhur që kam pritur dy javë për të shkruar disa fjali në fundin e një tregimi.

HEMINGËAY THOTË SE SHKRUAJ MË MIRË KUR JAM I DASHURUAR... SA NDIKON GJENDJA EMOCIONALE TE SHKRIMTARI?

Ndjenja e dashurisë krijon një "çregullim" hormonal, çrregullim që mund të stimulojë procesin krijues. Por të jesh i dashuruar a nuk do të thotë që të jesh njëkohësisht i lumtur? A nuk e shikojmë dashurinë si eliksirin e lumturisë sonë? Ndërkaq, siç shkruan Andrei Tarkovski "njeriu nuk është krijuar për lumturinë. Ekzistojnë gjëra më të rëndësishme se lumturia". Dhe arti, letërsia veçanërisht, qëndron pikërisht në kërkimin e këtyre "gjërave më të rëndësishme" si një udhëtim pa kthim në misterin e ekzistencës dhe metafizikën e qenies.

Ç'NDODH KUR NJË TREGIM A NJË DORËSHKRIM PËRFUNDON? SI PËRJETOHET TE JU FUNDI I NJË DORËSHKRIMI?

Përfundimin e një dorëshkrimi gjithmonë e shoqëron një pështjellim ndjenjash: kënaqësia se ia dole mbanë, entuziazmi se ke krijuar diçka të bukur, të mëvetshme, të papërsëritshme

dhe dyshimi i atypëratyshëm, frika, paniku se ke dështuar dhe gjithë ai mund është i shkuar dëm. Është mirë kur ke një mik të besuar, i cili e lexon dorëshkrimin tënd dhe të shpreh një opinion rreth tekstit të shkruar. Edhe pse zakonisht jam një dëgjues i keq, gjithnjë këmbëngul në timen. Por ndërkaq është e rëndësishme të jesh një lexues i mirë dhe i ftohtë i tekstit tënd. Fundja nuk thonë kot se "askush nuk e di më mirë se i zoti i shtëpisë se ku i pikon çatia". Kështu që gjithnjë kam drojë ta lexoj një dorëshkrim timin, i rri larg, ndoshta për muaj të tërë. Dhe ndodh shpesh që rileximi shoqërohet me një braktisje përfundimtare të tekstit dhe gjithçka fillon nga e para.

SHKRIMTARI NUK MUND T'I LARGOHET SHUMË JETËS SË TIJ, SA ËSHTË JETA JUAJ NË LIBRAT QË KENI SHKRUAR?

Librat e mi, janë jeta ime. Jo në kuptimin e rëndomtë se janë një ditar i ngjarjeve dhe historive të jetuara prej meje. Në librat e mi janë emocionet, ndjenjat, imagjinata, vizionet, ëndrrat, koshienca dhe subkoshienca ime, vetja ime e shfaqur në formën e saj më të lartë, atë kreative. Në këtë kontekst, në secilin tregim jam unë dhe askush tjetër. Secili tregim ka daktilogramin e gishtërinjve të mi, elektrokardiogramin e zemrës sime. Unë nuk mund të shkruaj një ngjarje të jetuar, një histori të vërtetë, një prozë dokumentare ose historike. Dhe unë në të vërtetë nuk i kuptoj ata që e shkruajnë, sepse është përtej ligjësisë të krijimit. Një ngjarje, një histori, mund të jetë një shkak, po kurrsesi një vepër letrare, një krijim letrar.

CILI ËSHTË AI MOMENTI QË JU LARGON NGA SHKRIMI?

Shumë të tillë. Dhe sidomos realiteti vulgar që shemb çdo iluzion, rrënon çdo shpresë. Banaliteti i jetës së përditshme dhe sidomos zhgënjimi nga njerëzit që ke dashur ta zbehin dëshirën për të jetuar dhe ta fashitin energjinë krijuese gjithashtu.

MUND TË NA TREGONI

HISTORINË SESI KA LINDUR NJË LIBËR TE JU, NJË LIBËR QË E VEÇONI?

Librat e mi, janë vëllime me tregime, kështu që në rastin më të mirë, mund të tregoj se si ka lindur një tregim. Po kthehem mbrapsht në kohë, te një nga tregimet e mi të parë, "Njeriu i dosjes". Asokohe, punoja në gazetë, kisha botuar shumë shkrime dhe disa prej eseve dhe tregimeve të para në shtyp. Takoj një ditë profesorin tim të gjenetikës, Zyri Bajrami, një nga miqtë e mi më të mirë edhe sot e kësaj dite, i cili përveç vlerësimeve për ato që kishte lexuar prej meje, po më këshillonte të shkoja në fakultet dhe të mbroja gradën shkencore, se në fund të fundit, sipas tij, ndryshe do të reagonin njerëzit, kur të shihnin krahas emrit, titullin Doktor i Shkencave, apo Profesor. E dija se vlerësimi i njerëzve për njeriun gjithnjë mbështetej, në tregues fiktivë, si posti zyrtar, ose titulli i dhënë nga të tjerët, por nuk e prisja këtë këshillë prej profesorit dhe mikut tim. Disa ditë qëndrova i tronditur, duke vrarë mendjen për këtë çështje: çfarë ishte e rëndësishme në këtë jetë, ajo që unë isha, apo ajo që unë dëshmoheja nëpër shkresa zyrtare, në dosjen time? Çfarë ishte më e rëndësishme, ajo që unë në të vërtetë isha, apo ajo që mendonin për mua turma e njerëzve në trotuarin përballë. Dhe në fund si duhet të jetoja, për vete, apo për sytë e botës? Kështu lindi "Njeriu i dosjes", një tregim i shkruar mbi konfliktin e përvetshëm midis asaj që ne jemi dhe atij tjetrit, njeriut të dosjes, që fle i strukur në dosjen tonë dhe në perceptimin e të tjerëve për ne. Njeriu i Dosjes, nuk isha unë po njeriu fiktiv që të tjerët kishin krijuar të tjerët për mua dhe konflikti dhe ndeshja me të do të ishte e përvetshme, sa kohë që unë nuk do të kujdesesha për të dhe unë jo vetëm s'do të kujdesesha po do ta shpërfillja dhe përbuzja këtë njeri shkatërrimtar. Kjo është pak a shumë historia se si lindi dhe u shkrua tregimi "Njeriu i dosjes". Nga ky këndvështrim secili tregim ka një histori të tijën që qëndron e padukshme pas aktit të shkrimit.

Bashkebisedoi,
Alda Bardhyli, nga gazeta
"SHQIP", 20 Korrik 2015

THETH – verë 2015

- Shënime -

NË NJË DREJTIM ...

Në kohën e mbërritjes së rrugës së makinës në Theth në vitin 1936, sipas Ernest Koliqi, qe shkruar: "Kemi ardhun si krushqit në darsëm, kemi ardhun për t'i a hjekë duvakun një nusjeje së mrekulueshme, kemi ardhun për t'i a zblue botës bukurinë e Thethit qi për mija vjetsh mbet e mshefun dh'e humbun." Pas çeljes së rrugës filloi një shfrytëzim barbar sidomos në prerjen dhe shitjejen e lëndës së drurit. U prenë shumë drurë të radhë si arra, palna, frashër, por edhe shumë pyje të zakonshme, për tu tregtuar, duke bërë një dëm shumë të madh pyjeve të virgjëra të Thethit dhe Alpeve Shqiptare. Duke parë këto dëmtime, Ernest Koliqi bënte thirrje të fuqishme që të ruhen pyjet, të ruhet natyra e bukur, e pasur dhe e pastër e Thethit. Ai shkruante: "Aman, tregtarë, aman malësorë, ne mos ju dhim të vendi, së paku vedin mos e fikni, sikur se njaj qi për të rrxue një landë me spatë i bie vedit nenit të kamës ... Aman qytetarë qi po delni me verue, aman, turista qi po silleni me kundru, merrni ato visare të ndërës, të besës, të burrnisë; mos ja grabitni Malësis, tue u lanë në kamë të tyne skepticismën e prishjen morale të vendeve ma t'ulta... Vetëm në një drejtim do të shkojë lëvizja tregtare sot nëpër shteg të ri të Thethit; do të çojë të mirat perpjetë, nuk do të grabisë për m'ulë të poshtë."

Këto këshilla, të këtij dukagjinasi dhe intelektualit të mirëfilltë, duhet të jenë parasysh edhe në ditët tona, pavarësisht ndryshimeve dhe trajtimit të zonave të mbrojtura, parqeve natyrore, për të pasur turizëm të qëndrueshëm edhe për brezat që vinë.

LAPIDARI NË QENDËR TË FSHATIT ...

Në qendër të fshatit Theth, buzë lumit me ujë të kthjelltë dhe të freskët kohët e fundit është ngritur një lapidarë, gdhendur në një gurë masiv dhe të punuar me kujdes nga Zef Muri, në kujtim të punonjëseve të Kryqit të Kuq Amerikan. Në prill të vitit 1921 mbërrin në Shkodër Roza



Lein, një udhëtare dhe studiuese nga Amerika, e cila ishte nisur për në Stamboll. Këtu takohet me dy bashkatdhetarë, punonjëse të Kryqit të Kuq Amerikan, të cilat po bëheshin gati që të udhëtonin për në Dukagjin, me synim Thethin. Ato i tregojnë zonjës Lein se kush nuk viziton malet shqiptare, "një ditë rrugë larg", nuk ka parë gjë, etj. Përfundimisht zonja Lein ndryshon mendimin dhe bashkohet me grupin që përgatitej për në Dukagjin. Pas një udhëtimi mjaft të lodhshëm jo vetëm një terreni i thyer, por edhe nga shiu që po i shoqëronte vazhdimisht, ditën e tretë të udhëtimit arrijnë në Theth.

Ato takohen me priftin Marjan Praela, të cilit i dhurojnë 3 450 korona sermi si ndihmë për shkollën që kishte hapur. Për kohën, kjo ishte ndihmë mjaftë e madhe. Kryqi i Kuq Amerikan, kishte kohë që vepronte edhe në Dukagjin. Duhet kujtuar se edhe në Besën e Prekalit të vitit 1919 tregohet posaçërisht kujdes për të ndihmuar këta punonjës, në çdo kohë sa herë që të jenë nevoja. Punonjëset që shkuan në Theth në pranverën e vitit 1921, fatkeqësisht, deri tash, nuk kemi vetëm emrin e mbiemrin e njëjës dhe vetëm emrin e tjetrës. Emrat e tyre janë Françeska Hardi dhe Aleksa, siç na thotë Autorja e librit "Majat e Shalës" Roza Lein, që i kushtohet këtij udhëtimi. Lapidari flet shumë, dhe më shumë do të shërbejnë brezave të ardhshëm.

OJF dhe fondacionet nuk duan të dinë çfarë është punuar më parë ...

Prej vitit 1995, në Theth kanë vepruar OJF, në disa fusha të jetës, por më shumë në drejtim të zhvillimit të turizmit, dhe pasurive mjedisore e kujdesin për të. Këto kanë dhënë një ndihmesë shumë të rëndësishme, por edhe kanë krijuar respekt dhe marrëdhënie miqësore që kanë mbetur si lidhje miqësore midis banorëve dhe këtyre operatorëve, gjithashtu, janë krijuar lidhje miqësore mjaftë të forta edhe midis banorëve vendas dhe turistëve nga vende të ndryshme të botës. Është rritur cilësia e shërbimit, banorët i trajtojnë vizitorët me shumë respekt, por që duhet bërë edhe më shumë. Duhet thënë se në këtë fshat turistik, ashtu si edhe në të tjera ndërhyrje, duken veçanërisht OJF pa një identitet të plotë, nuk janë transparente, e quajnë veprimtarinë e tyre si bamirësi personale, nuk publikojnë një plan të veprimtarisë së tyre, bashkëpunojnë pak me komunitetin, nuk janë transparent në mbledhjen dhe shpërndarjen financiare. Në këtë pikë shteti është e nevojshme të nxjerrin ligje që do të mundësojnë transparencën e veprimtarisë së tyre. Nuk është e kuptueshme, dhe normale, se pse OJF ose fondacione nuk përmendin farë punën që është bërë më parë. Pothuaj të gjithë e paraqesin veprimtarinë e tyre në një territor të caktuar si të filluar nga zeroja, si një veprimtari që po fillon në tokë të shkretuar, në një tokë boshe. Këto nuk e përmendin fare punën e bërë nga paraardhësit e tyre në fusha përkatëse ose edhe të përafërta. Nuk fillon jeta, nuk fil-



lon zhvillimi e përparimi vetëm me veprimtarinë e çastit. Planifikimi dhe zbatimi i një projekti duhet të mbështetet në zhvillimet dhe përparimet e mëparshme.

Në një bisedë që rastësisht kisha këto ditë më një drejtues të rëndësishëm të një fondacioni, midis të tjerash u shpreh se do të bënte "çelje shtigjesh" dhe "shënime drejtimesh" për turistët në Theth. Ai ose nuk e dinte, ose nuk donte ta dinte se në Theth ka kohë që është punuar në këtë drejtim. Fare të pakta mund janë rrugët dhe shtigjet në Theth dhe rrotull tij që nuk janë të përcaktuara. Po, gjithmonë ka nevoja për të përmirësuar punën, por kur fillohet mbi punën e dikujt tjetër, është më e mundur, ka më shumë mundësi, dhe ka më shumë rezultate. Nuk duhet të harrojmë se një nga dëmtuesit e mjedisit është edhe turizmi nëpërmes nxitjes së erozionit nga rrugëtimet, dëmtimi i florës dhe faunës, ndotjes së mjedisit, dhe që për këto duhet të mendohet mirë para se të krijohet guida për vizitorët. Të bimët endemike mund të shkojnë shumë kush, por disa u a dinë rëndësinë, të tjerët mund të vënë dorë mbi to, duke e menduar si një bimësi e zakonshme, jo për të gjithë është normale të afrohet të strofull e ariut apo riqebullit. Këtu e ka vendin zoologu, botanisti, studiuesi, të tjerët e kanë vendin atje ku kanë interes, etj. etj. Prandaj edhe në përcaktimin e guidave duhet bërë kujdes, që secili të pyetet se çfarë kërkese ka, ti shpjegohet mundësia, pse jo edhe vështirësitë, apo rrezikun, të propozohen mundësi që turistët nuk i dinë, pastaj të veprohet.

PO NDËRTOHET ...

Disa vite më parë kam shkruar "S. O. S. Thethi po shkretohet", duke parë vrullin e malësorëve për tu larguar nga ky fshat. Mbeten 12 familje me banim të përherëshëm në Theth. A nuk përbënte problem për këtë fshat-perlë të natyrës jo vetëm në Shqipëri por edhe shumë më gjerë. Por koha solli ndryshime të rëndësishme. Filloi rigjallërimi i fshatit, ngritja e objekteve turistike, përshtatja e shtëpive për pritje të vizitorëve, ngritja e kulturës së shërbimit, ndërtimi i hoteleve të mirëfillta turistike, çelja e shtigjeve dhe shënimi i rrugëve për turistët, etj. Kjo po rritet dita ditës, veçanërisht gjatë stinës së verës, por po

synohet që të jenë turizëm gjithëvjetor. Zhvillimi i fshatit po ndikon fort edhe në ringritjen apo ngritjen e shtëpive të banimit, apo edhe me funksion të përbashkët për banim dhe pritje turistësh. Ndërtime po bëhen në të gjitha lagjet e fshatit, të bukura, të forta dhe duke ruajtur arkitekturën tradicionale. Kjo është shumë e mirë. Por duhet thënë se ka ndonjë rast që po duket hekuri dhe betoni.

Kjo nuk është normale për natyrën e fshatit, nuk është normale as për turistët, nuk është normale as për perspektivën, nuk është normale as për kulturën tradicionale të fshatit dhe krahinës. Kjo nuk është mirë që të ndodhë. Secili duhet të mendojë për të ruajtur natyrën e pastër, të bukur dhe origjinale. Kjo është bukuria, kjo sjellë zhvillim, kjo sjellë vizitor, turistë. Natyrisht banorët duhet dhe do të jetojnë, por përshtatje me natyrën e ndërtimeve tradicionale është domosdoshmëri. Po, po ndërtohet, por duhet bërë shumë kujdes për sot dhe për të ardhmen. Duhet krijuar mundësi dhe hapësira për të gjithë banorët. Domosdoshmëri duhet të mbrohet kultura tradicionale në ndërtime dhe ushqime, natyrisht sa të jenë e mundur. Si në çdo rast, edhe këtu duhet të duket dora e shtetit, për të ndihmuar me durim dhe kulturë banorët.

PO KTHEHEN EMIGRANTËT ...

Është shumë kënaqësi kur shikon djem dhe vajza thethjanë që po kthehen nga emigracioni, duke ju drejtuar vendlindjes. Ata tash janë bërë prindër në shumicën prej tyre. Ndonjëri thotë më dhembje, por që shprehë edhe vështirësitë e shumta të punës në emigracion. "Mjaft punova, gati 20 vjet, prrenjëve, maleve e pyjeve në Itali. Tjetër të mirë nuk pata vetëm punova, por dhe gati humba rininë atje. Këtu do të përpiqem për të riorganizuar jetën dhe punën" –thotë Gëzimi, një emigrant i sapo kthyer.

Kudo që kanë punuar dhe jetuar, emigrantët, kanë fituar një përvojë jo të vogël, që mund tu vlejë edhe në punën e tyre këtu. Gjithsesi kthimi i tyre është me vlera për fshatin dhe zonën, për sot dhe të ardhmen.

Përgatit Luigj SHYTI

MARK BREGU - DASHAMIRËS I DUKAGJINASVE

KUSH ËSHTË MARK BREGU DHE CILI KA QENË RRUGA E PUNËS SË TIJ DERI SA DOLI NË PENSION?

Jam një qytetar shkodran me origjinë nga Mërturi. Banoj në këtë qytet që në moshën 9 vjeçare, ku se bashkë me vëlla Zefin, jemi rrit dhe edukuar në shtëpinë e fëmijës. Shkodra më dha shkollën e kulturën ndërsa Mërturi më dhuroj guxim si trashëgimi gjenetike. Ky guxim i trashëguar nga geni dhe kultura e fituar në këtë qytet, i cili është kryefjala e kulturës mbarnacionale, më ndërjegjësuan që të bëhem një qytetar i vlefshëm duke e pas gjithnjë kokën lart. Si çdo njeri edhe unë kam pas probleme gjatë jetës, por i kam zgjidhur me urtësi, guxim e mirëkuptim duke shmangur çdo konfliktualitet. Kam qenë njeri i punës dhe i sakrificës. Kam punuar në ndërmarrje të ndryshme shtetërore sidomos ato hidroenergetike, në sektorin elektrik dhe në atë të kulturës falë aftësive letrare – artistike dhe humorit që Shkodra më dha, i cili më ka shoqëruar gjatë gjithë jetës.

KENI NJË PRODHIMTARI TË LARTË LETRARE. MUND TË NA FLISNI MË KONKRETISHT? SI ËSHTË VLERËSUAR AJO DHE A KENI NDNJË PROJEKT PËR TË ARDHMEN?

Është e vërtetë se kam një krijimtari të bollshme letrare. Kam botuar shumë libra në prozë, në poezi e në publicistikë. Kjo më shumë si dhunti dhe dhuratë nga Zot, sepse nuk kam kryer ndonjë fakultet të kësaj fushe. Njeriu ndjen sadsifaksion kur puna e tij vlerësohet dhe akoma më e madhe është kënaqësia, kur vlerësohesh nga personalitete me shumë vlera dhe kontribute në fushën e letrave. Duke mos qenë shumë modest dëshiroj t' i përmendi disa figura me grada e tituj shkencor që e kanë vlerësuar punën time si: Eruditi Lekë Përvizi – Bruksel Belgjikë; prof. doktor Simon Pepa; shkrimtari, dramaturgu, Mjeshtri i Madh, Fadil Kraja; Mark Krasniqi – profesor dhe akademik në Prishtinë; avokati, publicisti e poeti Suat Haxhi; Monsinjor Zef Simoni; Tomë Mriaj-shkrimtar e poet në SHBA; Lekë Ymeraj - shkrimtar, përkthyes e psikolog; prof. doktor Zef Gjetja – studiues; Marash Mhilli – shkrimtar e poet; Kadri Ujkaj – kritik letrar; Tonin Vasa – shkrimtar; Luigj Temali – poet e shkrimtar; Viktor Paloka – rapsod e krijues; Prel Milani – historian, shkrimtar e poet e te tjerë e te tjerë. Autorët e lartpërmendur dhe shumë të tjerë, vlerësimet i kanë dhënë me autografe në librat që më kanë dhuruar të cilat i ruaj me fanatizëm në bibliotekën time modeste. Nëse më lejoni dua t' i veçoj disa si: Marash Mhilli: "Mark Bregu mbetet si lumi i Cemit që s' mund t' i mbyllësh burimin. Grykëderdhja e atij lumi është vikama e tij". Prelë Milani, në parathënien e librit tim "Shakaxhinjtë e nacionalizmit", shkruan "Ai është dashnor shembullor i fjalës së lirë, është avokat i së vërtetës të cilën kërkon ta shkond nga pluhuri i harresës, kërkon të



gërmojë e ta gjejë atje ku është qoftë edhe në varr". Të gjithë ata që përmenda kanë shprehje të goditura e inkurajuese, por nuk po i citoj për të mos zënë shumë vend në këtë gazetë të nderuar. Mbrësëlënës dhe shumë i vlerësuar ka qenë bashkëpunimi me kompozitorët më në zë të Shkodrës e më gjerë me në krye të madhin Pjetër Gaci, si autor tekstesh. Projekte për të ardhmen nuk kam sepse moshë dhe ana shëndetësore e bëjnë punën e vet. Megjithatë do të ja lëmë kohës.

JENI DASHAMIRËS I DUKAGJINIT E DUKAGJINASVE. CILI ËSHTË OPINION JUAJ?

Kam qenë, jam e do të jem dashamirës i Dukagjinit, i kësaj perle të veriut shqiptar, sepse ka nxjerrë nga gjiri i tij figura të shquara, me mendje të kthjellët, shpirt të madh dhe zemër të fuqishme që kurrë nuk u mposhtën as nga pushtuesit barbar dhe as diktatorët sundimtar duke filluar me Mark Lulën, Mehmet Shpendin dhe deri tek intelektualit dhe atdhetari i shquar profesor Kolë Prela. Kam respekt shumë të madh për dukagjinasi, sepse janë shumë vital e kurajoz, të cilët kanë dhënë dhe po japin kontribut në të gjithë sektorët e jetës, në ekonomi, në ushtri, në arsim, në kulturë, në shëndetësi, në sport, në art, në administratë e te tjerë, duke bërë emër jo vetëm në Dukagjin e Shkodër, por në të gjithë Shqipërinë. Pse, më kanë pëlqyer kam bërë 4 herë miqësi me ta.

ÇFARË VLERËSIMI KENI PËR SHOQATËN "ATDHETARE DUKAGJINI" DHE GAZETËN E SAJ "DUKAGJINI"?

Është shoqatë shumë atdhetare e krijuar dhe e mbajtur gjallë nga dukagjinasi të shquar dhe tepër të përkushtuar në shërbim të çështjes nacionale. Njëpërmjet hulumtimit dhe veprimtarisë së saj kanë nxjerrë në pah e promovua vlerat më të vyera të Dukagjinit duke i pasqyruar në gazetën

e saj "Dukagjini", e vetmja në veriun shqiptar, në të cilën shkruajnë penda të temperuara në burimet më të kthjellta të bjeshkëve të kësaj zone krenare. Vlen të theksojmë se kjo gazetë mbijeton me fondet e fisnikërisë të bijve dukagjinasi në një kohë që njësitë vendore dhe biznesmenët nuk e kanë bërë një hap të tillë. Është për t' u pasur zili dhe është pozitiv fakti se, përveç veprimtarive të shumta, janë promovuar shumë libra me autor dukagjinasi, të cilët kanë pas një krijimtari të pasur sasiore e cilësore, sidomos që me formimin e shoqatës. Njëkohësisht është për t' u vlerësuar shumë fakti se me insistim të drejtuesve të shoqatës "Atdhetare Dukagjini" janë vlerësuar e shkond nga pluhuri i harresës shumë figura të shquara dukagjinase. I uroj gazetës "Dukagjini" që të mbetet edhe në të ardhmen përfaqësuesja më dinitoze e medias së shkruar.

Je një ndër studiuesit e figurave që i kanë dhënë Shkodrës e kombit. Na thuj diçka më konkretisht.

Padyshim që idhulli im është Luigj Gurakuqi dhe për mua njeriu më i madh i shekullit të njëzetë. Asnjëherë nuk ju ka dhënë vlerësimi që meriton, me insistimin tim, duke ju drejtuar instancave më të larta të shtetit që i kam të dokumentuara, mori emrin e tij universiteti i Shkodrës, si dhe u vendos shtatorja e tij në qendër të qytetit. Po me insistimin tim qendra kulturore e qytetit mori emrin e kompozitorit të madh, mikut e bashkëpunëtorit tim, Pjetër Gaci. Kam bërë mjaft përpjekje që të u jepet vlerësimi që meritojnë edhe shumë personaliteteve të tjera të Shkodrës e më gjerë si Ismail Ahmetit e të tjerë.

ÇFARË MESAZHI JU JEPNI MALËSORËVE NË PËRGJITHËSI DHE DUKAGJINASVE NË VEÇANTI TË VENDOSUR NË VENDBANIMET E REJA NË QYTET APO RRETH TIJ?

Si shumë qytete të Shqipërisë edhe Shkodra pati "rrjedhje" ku një pjesë e

ndjeshme e rinisë u largua për një jetë më të mirë, por ky "vakum" u mbush me të ardhur nga zonat malore, sidomos nga Dukagjini, të cilët u vendosë në Shkodër e rreth saj. Banorët e rinj të ardhur nga kjo zone, pa humbur asgjë nga trashëgimia e traditave brilante, iu bashkuan qytetarisë shkodrane duke i marrë asaj trashëgiminë kulturore. Bashkimi i këtyre komponentëve do të jetë faktor specifik, që do ta çojë më lart emrin e qytetarit shkodran. Zemra e fuqishme dhe vitale e malësorit dukagjinasi dhe mëndja e ndritur e qytetarit shkodran do të na dhurojnë qytetarin e përkryer dhe jam i bindur se do të ja ngrenë akoma më lart emrin Shkodrës. Rinia e ardhur nga Dukagjini nuk duhet të bëhet "pre" e veseve negative, të cilat shpesh na i dhurojnë mediat. Ata duhet të qëndrojnë sa më pranë shkollës dhe sa më larg plagëve të krijuara nga tranzicioni.

I nderuar Mark, Ju faleminderit për bashkëbisedimin, për fjalët e mira dhe vlerësimet që dhatë për Dukagjinin e dukagjinasi, për shoqatën "Atdhetare Dukagjini" dhe gazetën e saj. Ju urojmë shëndet, jetë të gjatë duke shpresuar se do të kontribuosh ende për Shkodrën dhe duke pasuruar krijimtarinë tuaj dhe duke sfiduar moshën!

Faleminderit juve, që ma dhatë mundësinë të komunikoj me bashkësinë dukagjinase e atë shkodrane dhe të paraqes copëza nga jeta dhe puna ime. Shpreh gatishtësinë për të bashkëpunuar edhe në të ardhmen me gazetën "Dukagjini"!

*bashkëbisedoi,
PRELË SHYTANI*

MJESHTRI I MAGJISË SKENIKE DHE TELEVIZIVE, OSMAN MULA RESPEKTOHET DHE NDEROHET NGA SHKODRA

“MJESHTRI I MADH” OSMAN MULA GJITHNJË DIALOGON ME KOHËN PËRMES VLERASH KONKURUESE NË MENDIM, MUZIKË, INTERPRETIM, REGJISURË, KULTURËN KOMBËTARE, TRADITËN DHE NË VEÇANTI STILIN SHKODRAN

Koloriti, vitaliteti dhe energjitë, kanë qenë përherë për të burime frymëzimi që e kanë ushqyer në të gjitha artet, duke i dhuruar atij talentin e pafund artistik, për ta bërë të njohur tashmë si një ndër regjisorët më të rëndësishëm të skenës shqiptare.

Temat e bisedave me Osmanin janë gjithmone interesante. Përveç të perdritshmeve vendin kryesor e zënë kujtimet dhe planet që natyrisht sa më serioze bëhen, më me humor ngjyrosen.

Edhe në kohët e mëparshme, edhe sot, ai si mjeshtrë i magjisë skenike dhe televizionit respektohet nga Shkodra si i barabartë mes të barabartëve, me nderim dhe krenari përkrah titanëve të artit shqiptar që “brumosi” ky qytet.

Mes shumë miqsh e shokësh të mbledhur për këtë vlerë të Shkodrës, që rrënjët e kujtimet më të thella i ka në këtë qytet, ku i qeshnin sytë dhe shpirti për Shkodrën, duke e parë të mëshiruar shprehjen “Boll me ken Shkodran, se tana i ban”, për punën dhe kontributin e shquar, për arritjet e suksesshme dhe kontribues në aktivitetet e organizuara veçanërisht në qytetin e Shkodrës, Osman Mula u vlerësua me titullin e lartë “Mirënjohja e qytetit”, i akorduar nga Bashkia e Shkodrës.

Ishte kryetari i Këshillit Bashkiak Bardhyl Lohja, i cili i dha edhe motivacionin e këtij vlerësimi për mjeshtrin e dhjetra festivaleve, qindra emisione muzikore, saksofonistit të talentuar dhe kompozitorit që çmimet e ndoqën nga pas, me motivacionin: Si shkodran që kontribuoi me përkushtim për evidentimin e vlerave artistike të qytetit të Shkodrës, duke i bërë ato të njohura në mbarë trevat shqiptare.

Z. Bardhyl Lohja i uroj që edhe në të ardhmen të shquhet në këto nivle të larta.

Ceremonia u organizua në hollin e teatrit “Migjeni”, institucionit ku Mula ka bashkëpunuar në vazhdimësi me plejadën e artistëve të këtij qyteti.

Aktorja e teatrit “Migjeni” Drande Xhaj e cila drejtoi këtë takim, pasi foli për punën dhe karrierën e suksesshme në vite të mjeshtrit Mula, ftoi disa nga emrat e njohur të skenës shkodrane dhe asaj shqiptare që me



vite bashkëpunuan me Osman Mulën, për të ndarë emocinet e kësaj dite.

Dramaturgu dhe shkrimtari i njohur prof. Fadil Kraja në fjalën e tij plot emocion tha: “Zoti, Osmanit i ka falur disa dhunti, disa talente; kompozitor, muzikant, gazetar, regjisor, por i ka falur edhe një talent tjetër që duhet ta çmojmë shumë. “Është shkodran i thekur». Në librin që i dhurova ia kam shkruar këtë dhunti”.

Më pas për ta urren Osman Mulën, fjalën e mori “Mjeshtri i madh” Bujar Qamili, i cili ndër të tjera u shpreh: “Osman Mula është Ambasadori jonë shkodran në Tiranë. Bujari në emër të aktoreve së madhe Zyliha Miloti, e cila nuk ndodhej në këtë takim, por që kishte porositur Bujarin, për t’i dhuruar një buqetë me lule Osmanit si shenjë respekti.

Falenderuan njëri pas tjetrit edhe aktori “Mjeshtri i madh” Gëzim Kruja dhe aktori i mirënjohur Besnik Çinari.

Më pas i emocionuar, regjisor Mula foli për mirësinë që i bëri qyteti i tij, duke theksuar se ky është një ndër momentet më të veçanta të jetës, madje ai nuk ngurroj të ndaj edhe amanetin që fëmijëve të tij iu ka lënë e që lidhet me shkodrën e dashur. Osman Mula në vazhdim tha: “Unë e admiroj këtë qytet dhe kam të drejtë, por jam i bindur që ky qytet është i madh në raport me të gjithë qytetet tjera në Shqipëri, ky qëndron shumë lart. Ka nxjerrur artistë të mëdhenj, të mrekullueshëm; aktorë, regjisorë, muzikantë, dramaturg, romancierë, sportistë, punëtorë, njerëz të të gjitha profesioneve. Ka nxjerrë këngën

popullore aq brilant, kompozitor aq të mrekullueshëm.

Si është e mundur që ky qytet me pas kaq stof, kaq njerëz të mëdhenj që sa fillojnë katër masat e para të veprave të një shkodrani, spektatori në sallë duartroket.

Osman Mula përjetësoi edhe emra të mëdhenj të artit muzikor në Shkodër si: Vëllaun i tij Fatos Mula, i cili ka qenë baterist me estraden, Prek Jakova, Leonard Deda, mikun e tij Nazmi Lishi, Fuat Miloti, Xhemal Uruçi, Luan Barova etj.

Rrespekt për çdo familje shkodrane, paçi bereqet, dashuri për njëri-tjetrin dhe shumë fat në fëmij, tha Osmani në mbylljen e fjalës së tij.

Osmani me dashurinë e tij për Shkodrën dhe emocionet që e përfshinë, na bëri të ndjehemi si një shpirt i ngazëlluar. Kishte shumë prej atyre që dëshironin për ta falenderuar për gjithçka përjetuan atë ditë.

Pas emisionit televiziv i titulluar “Aromë Shkodre” të drejtuar nga moderatorja dhe gazetarja e njohur Kozeta Bruçi që u organizua në një nga ambientet e “Grand Hotel Europa”, ku ishin të ftuar prof. Fadil Kraja, një ndër dramaturgët më të artë të dramaturgjisë shqiptare, si dhe këngëtarit Bujar Qamili “Mjeshtrë i Madh”, Osman Mula rrëfjesh dashurinë e pakufishme që ai ka për Shkodrën dhe shkodranët. Në fund të emisionit ai këndoi këngën “Pranverë, pranverë”, për të demonstruar energjinë dhe forcën artistike që Shkodrës nuk i shteron në asnjë stinë të vitit.

Regjisorin dhe kompozitorin i njohur shqiptar Osman Mula

“Mjeshtrë i Madh” nga Shkodra, është një nga regjisorët më të njohur në Radiotelevizionin Shqiptar, drejtues i dhjetë festivaleve, qindra emisioneve të muzikës, saksofonist i talentuar dhe kompozitor i vlerësuar me shumë çmime.

I lindur në Shkodër më 31 mars 1951. Ai ka një karrierë të pasur artistike, ku përveç angazhimit në RTSH, Mula u vlerësua edhe me shumë çmime si kompozitor.

Kreu studimet në Institutin e Lartë të Arteve dega e Artit Dramatik në vitin ‘70-’74 dhe emërohet regjisor në Radio Televizionin Shqiptar në vitin ‘73. Ndërkohë mbrojti diplomën në Teatrin Popullor, realizoi koncertin e Vitit të Ri dhe pas një viti festivalin e këngës në RTSH, duke mos u shkëputur për vite me radhë nga institucioni, nga ku ka zbuluar talente në artet prezantuese dhe media, duke i formuar profesionalisht, si dhe duke i dhënë drejtim disa të rinjve si folës në ekran.

Vjen nga një familje e njohur, emrin e së cilës e kanë ngritur lart dhe e kanë nderuar duke përcjellë dashurinë për profesionin dhe muzikën figura të tilla si gjigandi Avni Mula, sopranoja me përmasa botërore Inva Mula e deri tek brezi më i ri siç janë fëmijët e Osmanit këngëtarja Evis Mula dhe aktori Enson Mula.

I tillë është i madhi Osman Mula, njeriu që ka zbuluar me dhjetëra talente dhe që e ka ngritur spektaklin në nivelet më të larta të kohës duke respektuar traditën dhe duke e harmonizuar me modernen.

Fillesat artistike nisin në

vendlindjen e tij në moshën 17 vjeçare kur ka marrë çmimin e parë si kompozitor në anketën e Radio Shkodrës me këngën e kënduar nga Tonin Tërshana “Përsëri pranë jush do kthehem”.

Luajti me instrumentin e saksofonit në festivalin e njëmbëdhjetë. Ka përformuar në festivalet e studentit, kur vazhonte studimet për artin dramatik. Ka kompozuar këngë në anketa muzikore dhe ka fituar çmim të parë me një këngë të kënduar nga Afërdita Zonja. Pastaj ka depërtuar në festivalet e këngës si kompozitor. Pas disa vitesh filloi regjinë e festivaleve kombëtare në RTSH, prej dhjetë vitesh radhazi, si dhe regjinë e koncerteve të vitit të ri.

Më pas këngët ia besoi këngëtarit Luan Zhegu, i cili ka marrë çmim të dytë në festivalin e Këngës në Radio. Ka shkruar në Koncertet e Pranverës me Luanin, duke bashkëpunuar afro tetë vjet. Është autor i videoklipit të parë të realizuar në Shqipëri me këngën “Bashkë me Fëmijët”.

Në vitin ‘92 vlerësohet me çmim të parë në festivalin e RTSH-së me këngën “Pesha e fatit” të kënduar nga Aleksandër Gjoka, Manjola Nallbani dhe Viktor Tahiraj.

Në vitin ‘96 ka shkruar një këngë për Luan Zhegun dhe Ledina Çelon, e cila mori çmimin e dytë.

Në vitin 2014 është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me titullin e lartë “Mjeshtrë i Madh”.

Në vitin 2014 regjisor Osman Mula ka realizuar një dokumentar televiziv për shkrimtarin dhe dramaturgun e famshëm prof. Fadil Kraja, si dhe një dokumentar për lumin “Buna”, duke evidentuar historinë, bukurinë dhe vlerat e veçanta turistike që ka Buna.

Regjisorin “Mjeshtrë i madh” Osman Mula u largua nga Shkodra me më shumë mirënjohje se sa vetë vlerësimi që i bëri Bashkia e Shkodrës, duke iu kujtuar bashkëqytetarëve, kolegëve dhe miqëve të shumtë se ai është dhe do jetë gjithmonë me ta, si një “shkodran i thekur”.

**Pergatite
RAMAZAN ÇEKA
qershor 2015**

Shterpësia e ideve bashkëudhëtare e paradoksëve të Tranzicionit

“NJERIU VDES, NACIONALITETET NGRIHEN DHE BIEN, POR IDETË JETOJNË, IDETË JANË TË PAVDEKSHME” - - XHON KENEDI



“Shqipëria kopsht i lulëzuar thoshte dikur famëkeqi e qoftëlargu.” Vini re...! Vini re...! Po japim lajmet...! Ju fletë shkëlqesia e tij zëdhënasi i parë i “Mbretit”, oh ç’na gjeti, kush nga ne pa u baltosur mbeti?!” O Perëndi ruaje këtë popull nga bëmat e tij, mos e lejo që ai të vijë përsëri se qoftë larg bëhet kërdi! Shekulli i ri...! Kohët po

ndryshojnë...! Një jetë e re lulëzon...! Evropa...! Unioni...! Vizioni...! Tranzicioni...! Reformat...! Idetë...! Pusht-eti...! Dopjo gjashta në dorë i mbeti...? Ikën minierat, industria e bakrit dhe e duhanit, pyjet...etj.! Rrofshin koncesionet...! Me gisht në gojë mbetën punëtorët...! Shyqyr Zotit kemi fasonët...! Bamirësia e filantropia ekuacione me shumë të panjohura, i bekoftë Perëndia...! Lum kush është mjeshtër i Lekut, shfrytëzimin e njeriut prej njeriut e ka dënuar edhe Papa Françesku. Ne jemi e vërteta, ligji dhe drejtësia, pas nesh vjen Historia...! Furça, kova e boja janë armët tona...! Me ato mposhtem çdo sundimtar, armik e tradhtar. Dikur ishim “koloni”...! Po deshtë mos e beso ti! “Fëmijët qanin, bërtisnin, uluritnin, kërkonin strehë, ngrohje, dritë, ujë, bukë, bukë! Vdiq Lili...! Kohë Migjeniane, mizerje e skamje...! Analfabetizëm, fanatizëm, “të çelen arkapijat”, kënetat e moçale, mushkonja dhe malarie. Papunësi masive, kriminelë e hajdutë multi milionerë...! Mjekësi “fals”, cinike, me çmime astronomike...! Gjakmarrje, drogë, korrupsion, prostitucion, martesat brenda llojit etj., që Krushkë Madhja e jonë, e paçim gjithmonë, në

vitet e Tranzicionit, si dhuratë nga Qielli për ne i solli.

“... Ai që mohan të kaluarën do ta dënojë e ardhmja”. Ngado që të shkoj ajo do ta zbuloj, ndëshkimit të saj askush s’mund ti shpëtoj...! Tranzicioni si kamion, në boshllëk shpesh herë xhiron, provën nuk e kalon, shpirtat i trazon! Pak-kush të kupton, nga një stad, raport, sistem ekonomiko-shoqëror “më i ulët” në një tjetër “më të lartë”, si ne qua non, synon. Urra...! Fitore...! E përmbysëm Monizmin bashkë me sigurinë e jetës, të punës, dinjitetit, shëndetit dhe arsimit për ti hapur rrugën “Manifestit”...!

Pa punë s’ka liri...! Në përpjekjen për rimëkëmbjen ekonomike është e domosdoshme që të gjithëve t’u sigurohet puna dhe që ajo është më esenciale, për të jetuar me dinjitet...” Karol Vojtila Rrota e historisë ndryshoi drejtimin. Kapitalizmi e Demokracia, i thanë njëra tjetrës nëna dhe e bija, e paskan burimin te kutia...! Atje ndodhen “Mrekullia” “Llapma e Ladinit”, “Idetë”, “Reformat”, e “Ardhmja” dhe “Siguria”...! Kusuret i paguan vegjëlja...! Sipas statistikave pjesëmarrja në votime pas viteve 90-të, si mesatare në shkallë republike, ka qenë rreth 50-

55 përqind. Të zgjedhurit nga votat e gjysmës së elektoratit merrnin pushtet të plotë sikur për ata të kishin votuar 100% e zgjedhësve...! Vota e çdo qytetarit vishet me “kostumet” më ekstravagante të demagogjisë e të dekorit...! Paradoksi .Njëri nga dy ose më shumë kandidatë do të zgjidhet pa tjetër pavarësisht totalit të votave në sasi e përqindje në raport me numrin e përgjithshëm të zgjedhësve! Kjo do të thotë që edhe në qoftë se dhjetëra e qindra mijëra njerëz, për shkaqe e motive të ndryshme nuk marrin pjesë në votime, përsëri muret shekullore të kalasë së Kapitalit, qëndrojnë të patundura nga çdo abstenim, uragan e stuhi...!

Idetë janë “motorët” gjeneruese të shpirtit. ...Ato nuk kanë mortje kurrë...! Dëgjoni, tha Velia, burra të fort ka sot Shqipëria dhe do të ketë për jetë e mot, nga kjo rrugë asgjë s’na lot. ...”Nuk do të lejojmë më vandalizmin e kujtesës, shpirtit dhe historisë tonë. E para gjë që duhet të bëjmë për simbolet e LANÇ është restaurimi dhe mirëmbajtja e tyre. Epoka e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare është epoka më e ndritur në historinë e popullit tonë...”

Përgatitë, Luigj Temali

NJË DITË NË SHENGGJIN

Bukurive të natyrës që zoti i ka falë Lezhës, radhë i gjënë në një vend tjetër. Detin, lumenjtë, fushat, malet të gërshetuara njëra me tjetrën. Mëndja të kthen pak kohë më parë, vetëm 4 vite. Nuk kishte ujë të pijshëm, mungonte energjia elektrike, ujërat e zeza derdheshin në det. Nuk bëhej fjalë për tualete, as për pastrim të rrerës. Gjatë plazhit të shoqërorin lopët e derrat, sikur bënë gara kush të hajë më pare lëvoret e shalqinjve e mbeturinat e tjera me origjinë bimore. Mungesa e këtyre prioritetëve të çonte edhe në mos funksionimin e shërbimeve të tjera. Rrugët ishin si para 25 viteve, madje edhe më keq. Edhe qendra kryesore e qytetit, mundë ta krahasojë me ndonjë qendër të ish ndonjë kooperative bujqësore të zonave të thella malore.

Gjithçka ka ndryshuar nga themelet. Por më kryesorja, ndryshoj mentaliteti i administratës, nën drejtimin e ish kryetarit të Komunës, Salvador Kaçaj. Për 4 vjet u bënë ndryshime të mëdha. Përfundojë impianti i ujërave të zeza, Sheshi në qendër të qytetit, shëtitoret, rruga nga lapidari i Fran Ivanajt deri te Ura e Merxhanit, u rriten me qindra m2 hapësirat e gjelbëruar. Çdo rrugë e lagjeve të komunës janë lidhur me asfalt. Furnizimi me energji elektrike tani nuk mungon vetëm me raste të shkëputura, për arsye të ndonjë defekti. Këto e të tjera e

kanë radhitur plazhin e Shëngjinit nder plazhet më të pëlqyera në vendin tonë. Me mijëra pushuese e frekuentojnë gjatë vitit plazhin e Shëngjinit. Të shumtë janë ata të cilët frekuentojnë plazhin e Rënës te Hedhur, ku çdo ditë po tërheqin më shumë pushues vendas e të huaj. I vetmi merak që më mbeti është se nuk përfundova asfaltimin e rrugës deri te Rëna e Hedhur, gjatë mandatit tim si kryetar Komune, shprehet Kaçaj, projekti është gati dhe jam i bindur se kjo do realizohet së shpejti nga bashkia e madhe.

Ne morëm disa prononcime nga pushuesit dhe konkretisht: Selimi nga Prishtina, shprehet se është shumë i kënaqur me kushtet që na afron plazhi i Shëngjinit, uji e rëra janë të pastra, nuk kemi mungesa të ujit të pijshëm as të rrymës elektrike. Mbi të gjitha është se, ka siguri të plotë dhe shërbimi shëndetësor është 24 orë. Po me të njëjtat konsiderata flasim disa pushuese nga Polonia, të cilët nepërmasë perkthyesit veçuan se: Ne kemi qënë me

pushime në plazhet e disa vendeve, madje edhe në ato të Bashkimit Evropian dhe kushtet këtu në Shëngjin nuk kanë fare diferencë. Madje shtojnë ata se, çmimet janë shumë më të leverdishme. Na bënë



pershtypje se ushqimet janë bio dhe kanë një shije të veçantë. Kështu u shprehe Klaudia dhe fëmijët e saj, Fabiani, Çalina e Viviana Vukaj. Jo më kot Ledia Gjergji, specialist në Drejtorinë e Gjendjes dhe Cilësisë se Mjedisit, bënë të ditur disa të dhëna nga monitorimi i deri tanishëm i cilësisë së ujërave në 12 plazhet kryesore. Plazhi i Shëngjinit klasifikohet në klasin “A”. Pra, nder plazhet më të pastra

në Shqipëri.

Shëngjini krahas plazheve, shquhet edhe për historinë dhe vendet historike e fetare, të cilat normalisht mund të vizitohen nga pushuesit vendas e të huaj. Nuk ishte rastësi që në mesin e shëtitores u vendosë shatatoria e At Zef Pëllumbit, shtatore kjo, që i bënë nderë, jo vetëm Shëngjinit, por të gjithë Shqipërisë.

Kënaqësinë pushuesve ua shton edhe shëtitjet në lagunën Këmall, Kune, Vajin e te tjerë. Këto vitet e fundit Shëngjinit e kanë vizituar shumë personalitete të larta nga Shqipëria, Kosova, Kroacia e vende të tjera të Ballkanit e më gjerë. Këto vizita kanë ndihmuar në promovimin e turizmit në Shëngjin. Në mesin e tyre kishte; ish President, Kryeministra, Ministra, Deputet, politikan e intelektual. Shumë prej tyre janë shpallur qytetar nderi, apo u është dhënë “Mirënjohja e qytetit të Shëngjinit”. Ne, asistua në një evident të tillë, ku në mes të tjerëve ju dha titulli “Mirënjohja e qytetit të Shëngjinit”, një shokut tim të vegjëlisë. Bëhet fjalë për Ndue Ziçin, me motivacionin: “Si një intelektual dhe personalitet i shquar në fushën e ekonomisë dhe të sigurisë. Ka dhënë një kontribut të shquar në mbrojtjen e portit të Shëngjinit në mars të vitit 1997, dhe në promovimin e vlerave turistike të këtij qyteti.”

Edhe unë u bashkova urimeve të pranishëmve, duke i uruar jetë të gjatë e të lumtur Ndue Ziçit!

Kisha vendosur të shkruaj për bukurinë e këtij qyteti dhe për transformimet e ndodhura këtu 4 vite, të cilat e kanë bërë Shëngjinit vend turistik Evropian. Por marrja e titullit nga shoku im ma shtojë ende dëshirën për të pasqyruar ndryshimet e mëdha të kësaj perle turistike, e t’i urojë popullit të Shëngjinit, mik pritës përparime më të mëdha në qytetin e tyre të bukur.

Përgatite nga Kole Bala

Turqit "pushtojnë" Shllakun ...

Atë që nuk arritën ta bënin me lufte, për të pushtuar malet e Shllakut, në periudhën otomane e realizuan këtë vit, me pushtimin ekonomik të luginës së Drinit. Është segmenti Karne-Palaj, ku dy firma të fuqishme kane marre në shfrytëzim minierën e bakrit Palaj-Gegaj dhe një tjetër firmë, po Turke ka marre në shfrytëzim ujin e Drinit, në vendin e quajtur "Ceka e Shllakut". Firma, që shfrytëzon minierën e bakrit, është mjaftuar me rrethimin e territorit të zonës duke vendosur roje të sigurisë, përreth zonës. Deri tani nuk është bere asnjë investim përveç

atij që ishte në gjendje gjate sistemit të centralizuar. Siç dihet nga specialistet e gjeologjisë kjo miniere ka sasi të madhe rezerva të bakrit dhe një përqindje e tij është ari. Ajo që të shqetëson nga kjo pasuri e madhe nëntokësore, që në vitet 1979-1090 kane qene të punësuar mbi 250 familje të zonës së Shllakut. Nga kjo miniere, minerali transportohej me automjete dhe anije drejt Vaut të Dejës, për në fabrikën e pasurimit të bakrit, në Fushe-Ares. Sot, në këtë miniere nuk ka asnjë të punësuar nga kjo zone.

Janë autoritete e larta shtetërore,

që kane dhanë lejen për shfrytëzimin e kësaj miniere, e cila nga pronaret Turq e shohin të arsyeshme t'ia japin një firmë tjetër, firmë Kineze, duke sjelle fitime pa shpenzime. Po në këtë segment, afër 6 km, një tjetër firmë Turke ka bllokuar sipërfaqen më të madhe në kasatën e Drinit, duke instaluar impiante për rritjen e peshkut. Një teknologji e re, që janë vendosur rreth 100 ton materiale plastike për rritje e peshkut. Këto materiale janë vendosur në Ceken e Shllakut, pranë fshatit Gegaj. Mjetet e vendosura kane bllokuar tërësisht lundrimin në liqenin

e Vaut të Dejës si dhe kanë krijuar një ndotje të madhe ekologjike. Në këtë mënyrë ka filluar dëmtimi i faunës së kësaj zone, siç është peshku tradicional, që rritet në këtë liqen dhe largimi i mjaftë shpendëve të rralle të zonës. Vendosja e këtyre pajisjeve pengon lëvizjen e lire të mjeteve lundruese në linjën ujore nga Vau i Dejës –Koman si dhe lëvizjet brenda fshatrave.

Shpresojmë, me organizimin e ri të pushtetit vendor të Bashkisë së Vaut të Dejës, këto firma do të kontrollohen dhe disiplinohen nga autoritetet përkatëse në dobi të banorëve të zonës.

Përgatiti Zef Nika

KUR DUHET, VËRTET, TË FLASIM DENJËSISHT SHQIP...

Së pari, urime dhe suksese ideatorëve të zhvillimit të një simpoziumi shkencor, në Malësinë e Madhe, më 28 gusht 2015. Duke ofruar gjithë bashkëpunimin tim, nëse kërkohet, si prolog, dua të solidarizohem me vërejtjen substanciale të z. Sytki Ndrecaj, kryetar i Shoqatës patriotike "Malësia e Madhe "Nderi i Kombit" gjë që më lind të drejtën të shtroj pyetjen: Vallë e dine ata që i kanë vënë, simpoziumit të pritshëm në Malësi, titullin "Tuzi dhe Malësia flasin shqip", se Tuzi dikur ka qene edhe kryeqendra e Malësisë Madhe.

Nëse tuzianët, bashkëmalësorët dhe bashkëvelezrit tanë, denbabaden, së paku 6000-3000 vjet para Krishtit, siç shprehen studiues grekë, në ditët tona nuk po janë korrekt me kultivimin e dashurisë për gjuhën shqipe tek brezi i ri, që po rritet, kjo është, si vërejtje analoge, edhe për shqiptarët kosovarë në Prizrenin tonë historik, kryeqendra e Shqipërisë në vitet 1878-1881, ndryshe kryeqyteti shqiptar, ku pati selinë qeveria shqiptare e dalë nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, apo më saktë qeveria e standardit më të lartë demokratik deri në ditët tona..Sot, mjerisht, më shumë se shqip, në Prizren (Kosovë), po flitet turqisht, sikurse në Manastir (Maqedoni) dhe Plavë-Guci (Mal i Zi) thuajse është braktisur krejtësisht shqipja.

Do të thoni me dëshirë nga vetë shqiptarët?. Jo, kjo kurrsesi, por si diktat, presion, terror psikologjik, ekonomik dhe politik, drejtpërdrejt apo të tërthortë, mbi ta sa nga qarqet antishqiptare, sidomos deri dje, po aq sa nga presioni i sofistikuar postmodern sllav, sikur edhe ai turkoshak përmes platformës neotomane prej vitit 2008 me "argumentin" antihistorik, se gjoja Perandoria Osmane nuk ka qenë pushtuese e Shqipërisë. Mos harroni se në Turqi, së paku mbi 5 milion shqiptarë që flasin shqip nuk guxojnë të ngrenë zërin përmes 50 përfaqësuesve të tyre, si shqiptarë, nga parti të ndryshme, në Kuvendin turk, sepse druan mos pësojnë fatin e kurdëve, kurse në mjediset shqiptare, tek ne, lloj-lloj turlish flasin

turqisht, arabisht propagandohen në dëm të identitetit tonë dhe ne verbërisht, edhe pse rrahim gjoksin se po shkojmë drejt Evropës, më shumë se t'u mësojmë fëmijëve tanë historinë tonë po u mësojmë të na bëhen simpatizantë rrymash apo sektesh fetare të ardhura nga Azia. Madje, për turp, si krim postmodern funksionon ideja e një kombi mysliman, në kurriz të përcaktimit dhe artikullimit publik, institucional, komb shqiptar, me synimin tinzar për të eliminuar identitetin shqiptar.

Kjo duhet të jetë substanca që mund të frymëzonte një simpozium serioz, në funksion të statusit dinjitoz të shqiptarëve, në këto hapësira. Fol, bre, fol fort, me zë të larte, se je shqiptar, kur fqinjët tanë kushedi se ku përpëliteshin me subkoshiençën e tyre, sikurse popuj të tjerë evropianë ende kacavirreshin prapambetjes së llahtarshme të primitivitetit, kur shqiptarët po hidhnin hapat e shëndetshëm, të qytetërimit të tyre, në trojet e veta.

Shoqëria civile ka për detyrë që përmes oponencës së vet të mbështesë, apo inkurajojë ato qëndrime publike, që vinë në akord me zgjidhje të favorshme dhe të drejta, për të ardhmen tonë si komb, të ofruara nga klasa jonë politike, por kjo nuk mund të arrihet kur të gjithë duam të bëjmë politikë në emër të kulltukofagisë, interesave të ulta të karrierës, ndryshe motivohemi, thjesht, nga ethet partiake sikurse kultpushteti i pasurimit vetjak të paskrupullt.

Shqipërinë tonë politike, sikurse atë natyrore, në çdo pëllëmbë të saj mund ta ndërtojnë suksesshëm vetëm shqiptarët, që jo vetëm kanë kodin e politikës integrale dhe të partneritetit real me aleatët e perëndimorë e te tjerë, por edhe që flasin, ushtrojnë dhe mbrojnë me dinjitet vetveten duke filluar nga ushtrimi, nderi dhe respekti për gjuhën shqipe. Kurrë nuk na lejohet të injorojmë mësimin e madh të historisë, se aty ku sot zhduket gjuha, nesër mohohet territori.

Kadri Ujkaj, kritik letrar

BASHKIMI EVROPIAN MBËSHTET SHOQERINE CIVILE NE SHQIPERI

4, 7 MILIONË EURO TË DESTINUARA PËR SEKTORIN JOQEVERITAR

Zyra për Shqipërinë e Projektit "Asistenca Teknike për organizatat e Shoqërisë Civile", (TACSO), organizoi para pak ditësh një seancë informimi me organizatat e shoqërisë civile të Qarkut të Shkodrës te interesuara për të marrë pjesë në thirrjet e njoftuara për propozime të shpallura në kuadër të Instrumentit Ndihmës për Shoqërinë Civile dhe Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut. Ishte i pranishëm me këtë rast edhe Drejtori i Projektit TACSO, Genci Pasko.



Përmes këtyre thirrjeve të herëpashershme të TACSO qysh nga viti 2009 kur edhe filloi ky program, synohet që të nxitet përfshirja e shoqërisë civile në sektorin e drejtësisë, në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si prioritete kyçe që duhen trajtuar nga Shqipëria si kushte të domosdoshme për çeljen e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Qëllimi i përgjithshëm i mbështetjes nga thirrja në fjalë është promovimi dhe forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve lidhur me strukturat drejtuese, partneritetin në nivel qendror dhe lokal si dhe i forcimit të qëndrueshmërisë financiare të tyre.

"Sektori jo-qeveritar në Shqipëri do të përfitojë për dy vitet në vijim edhe Instrumentin Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut, (EIDHR) i cili ka në fokus forcimin e të drejtave të grave, fëmijëve, pakicave, personave LGBTI dhe grupeve të tjera të cenueshme. Vlera e përgjithshme e fondeve të nga këto dy thirrje kap shumën e 4. 7 milion EUR. E veçanta e këtyre thirrjeve është që ato synojnë të mbështesin organizatat e vogla dhe sidomos ato që veprojnë në zonat e largëta dhe periferike të Shqipërisë, të cilat do të ndihmohen përmes grandeve të vogla dhe mbështetjes financiare me procedura të lehtësuara", u shpreh ndërmjet të tjerash për të pranishmit Drejtori i Projektit TACSO për Shqipërinë, Genci Pasko, i cili shpjegoi në vijim për pjesëmarrësit kërkesat dhe procedurat e aplikimit nga këto thirrje me qëllim thithjen në një masë optimale të tyre.

ARBEN LAGRETA

Forcën dhe inspirimin e gjejë tek populli im i mrekullueshëm...!

BASHKËBISEDIM, ME PUBLICISTIN DHE GAZETARIN FLORIM ZEQA

Dikur ekzistonte grupi muzikor "Na bashkoi kënga popullore" (nuk kam njohuri a ekziston ende!?), një emër shumë karakteristikë, që është në të njëjtën kohë me bashkëbiseduesin e këtij bashkëbisedimi, por jo me këngën! Mua, me zotën Florim Zeqa na njohu e bashkoi aktiviteti, gazetaria, publicistika, mësuesia,...

Me aktivitetin, u njohëm për herë të parë në takimin e organizuar nga Ministria e Diasporës me bashkatdhetarët rreth projekt Strategjisë për Diasporën, mbajtur në Treviso...

Me gazetari e publicistikë u ndeshëm në faqet e gazetave, faqeve informative, për mes komenteve, reportazheve, shkrimeve gazetareske, e te tjera.

Dhe së fundit, me mësuesin, na lidhi rasti i iniciativës për hapjen e një paralele të Shkollës Shqipe në Quinto në kuadër të Shkollës Shqipe të Trevisos, ku pata rastin të njihem më gjerësisht për jetën, veprimtarin dhe kontributin e tij në aktivitete, publicistikë,.... dhe si ish mësues në atdhe. Andaj, nuk e humba rastin ta kërkojë një bashkëbisedim me te, i cili e pranoi me kënaqësi.

Para se të filloj bisedën, me zotën Florim Zeqa, lexuesi të njihem me profilin e tuaj shkurtimisht, për ti lenë hapësirë bisedës në vijim, për detajet më karakteristike të jetës dhe aktivitetit tuaj atdhetar dhe politik.

Kush është publicisti Florim Zeqa ?

U lind në 30 gusht të vitit 1963 në Bokshiq të Klinës. Shkollën fillore e kreu në Grabanicë, të mesmen në Klinë, ndërsa studimet në fakultetin Xeharo-Metalurgjik në Mitrovicë.

Me 11 mars 1982, në përvjetorin e demonstratave të vitit 1981, arrestohet nga forcat policore serbe në Mitrovicë. Në vitin 1990 fillon aktivitetin politik në Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Në kohën kur regjimi pushtues serb sulmoi arsimin shqip, si dhe duke i larguar nxënësit shqiptarë nga objektet shkollore, Florim Zeqa emërohet kryetar i Komisionit "Ndhimë me kuadro" për arsimin shqip në komunën e Klinës. Po ashtu, ishte një ndër organizatorët e protestave 1989 / 90. Bashkëbisedues në mosndryshimin e emrave të shkollës fillore "Azem Bejta", të shkollës së mesme "Luigj Gurakuqi". Ishte anëtar i strukturave rezistuese, kundër pushtuesit, në nivel të rajonal në Grabanicë. Punoi si mësues në shkollën fillore "Azem Bejta" në Grabanicë...

Edhe në emigrim, Florim Zeqa vazhdon veprimtarinë atdhetare në organizimin e mërgatës shqiptare në Itali duke u vënë në ballë të shumë nismave e aksioneve humanitare për Kosovë, si:

- Iniciator i peticionit kundër ish-ministrit të punëve të jashtme të Italisë, në prill të vitit 1998,

- Iniciator i parë në ndihmë të fondeve të luftës,

- Propozues i parë për kryetar të fondit Vendlindja Thërret, për regjionin e Venetos, të cilin post e ka refuzuar,

- Pjesëmarrës i shumë aksioneve humanitare në ndihmë të popullatës, gjatë luftës në Kosovë,

- Donator aktiv edhe i fondit të Qeverisë së Republikës të Kosovës, të udhëhequr nga Bukoshi, që nga 3 përqindëshi e deri tek aksioni me nga 1000 DM.

Florim Zeqa, ishte përfaqësues i të huajve në La Rete Interistituzionale, në rajonin e tij ku banon, një organizatë që merret me organizimin dhe mbarëvajtjen e nxënësve të huaj në shkollat italiane.

Pastaj, pjesëmarrës në shumë ekspozita multietnike, e që Kosovën e ka përfaqësuar me dinjitet të madh me vlerat e saja etnike.

-Ishte iniciator për krijimin e Lidhjes së Shqiptarëve të Kosovës, që kishte për qëllim unifikimin e të gjithë shqiptarëve jo vetëm në provincën e Trevisos, por edhe në nivel regional e më gjerë.

-Iniciativa e fundit është themelimi i paraleles së mësimi plotësues të gjuhës shqipe në Quinto (TV).

Nga profili juaj shihet se, kenë pasur një veprimtar dhe kontribut të madh në Kosovë, derisa u detyruat të largoheni. Pse zgjidhët shtetin Italian, kur shumë aktivistë të asaj kohe kërkonin strehim në Zvicër e Gjermani ...?

Ashtu sikurse largimi nga vendlindja që është zgjidhja e fundit, edhe Italia mbeti zgjidhja e fundit për mua. Pas një qëndrimi gjashtë mujor në Maribor të Sllovenisë u nisa në drejtim të Zvicrës ... në Itali u ndala për pak ditë derisa të gjejë ndonjë lidhje për të vazhduar tutje, por fati e deshi që Italia të mbetet vendqëndrimi i fundit...!

Kur dhe cila është arsyeja që Ju u detyruat të largoheni nga Kosova?

Me 23 shkurt të vitit 1993, fshati im i lindjes (Bokshiq) sulmohet nga forca të shumta policore serbe, ku detyrohem të kaloj në arrati. Me 7 mars po të njëjtit vit, arrestohem në fshatin Vitomiricë të Pejës. Pas një rrahje brutale deri në alivanosje, forcat policore serbe më hedhin në një kanal, ku gjendem dhe ndihmohem nga një kalimtar rasti. Pas përndjekjeve sistematike më kufizohet dukshëm veprimi im atdhetar. Andaj, në qershor të vitit 1995 detyrohem të largohem nga Kosova. Fillimisht në Slloveni, për të kaluar pastaj në Itali, ku jetoj e punoj edhe sot e kësaj dite.

Këtu në Itali, si e gjete mërgatën shqiptare, veçanërisht atë kosovare të organizuar?

Mërgatën shqiptare këtu në Itali e gjeta numerikisht shumë më të vogël se tani, por dukshëm më të bashkuar rrethe idealeve nacionale. Pas marrjes së leje-qëndrimit në Itali, menjëherë u interesova për organizimin e mërgatës. Nga bashkatdhetarët mora informacionet për ekzistencën e shoqatës "Besa" në Treviso. Fillimisht kontaktet e para i

vura me kryetarin e kësaj shoqate, zotën Fadi Osman, me të cilin u akordua për riorganizimin e shoqatës. Pas mbajtjes së kuvendit zgjedhor, çdo gjë e vumë në binar të shëndoshë, duke e funksionalizuar shoqatën në të gjitha segmentet e saj. Jo rastësisht, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, shoqata "Besa" ishte ndër më të organizuarat në nivel shoqatash në shtetin italian. Gjatë periudhës së luftës në aksionin humanitar "Ndhimë për Kosovë", shoqata "Besa" (Treviso) u rendit e para në nivel të shoqatave shqiptare në Itali për grumbullimin e mjeteve financiare për vëllezërit tonë nën flakët e luftës në Kosovë



Përveç angazhimit vullnetar si individ, ke pasur edhe ndonjë përgjegjësi të caktuar para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës së Kosovës?

Mbase për veprimtarët e viteve të '90-ta, aspekti humanitar është prezent edhe në ditët e sotme, objektivi i yni ka qenë dhe ka mbete dhënia gjithçka nga vetja e jonë për të mirën e shtetit dhe shoqërisë pa dallime ideologjike, fetare apo rajonale. Sa u përket angazhimeve konkrete, në fillim të viteve të '90-ta kam qenë i organizuar në lëvizjen paqësore për çlirimin e Kosovës (LDK), për disa vite kam qenë nënkryetar i degës së FR të LDK në Klinë, ku kam udhëhequr edhe komisionin për informim, kam qenë përfaqësues në bashkësinë e degëve të FR të LDK-së (Klinë, Gillogovc, Skenderaj dhe Malishevë). Gjatë periudhës së luftës kam qenë i organizuar në kryesinë e shoqatës "Besa" në Treviso, pjesëmarrës në të gjitha aksionet humanitare për Kosovë. Ndërsa pas luftës për shkaqe subjektive jam larguar nga aktiviteti i kësaj shoqate.

Meqenëse këtu ku jeton e vepron (në Itali) nuk ka degë të partive politike, sikurse në shtetet tjera perëndimore, cili është mendimi juaj për shoqatat ekzistuese ?

Po, është e vërtetë se nuk ka pasur dhe nuk ka degë të partive politike kosovare në Itali. Para dhe gjatë luftës shoqatat nuk kanë qenë të ndikuara nga partitë politike, mirëpo për fat të keq, pas përfundimit të luftës, edhe pse nuk e shfaqin publikisht, cila më pak e cila më shumë kanë rënë nën ndikimin e partive politike. Mjafton të përcjellsh aktivitetet e tyre,.... nga paraqitja skenike e deri të përmbajtja nënkuptohet ndikimi partiak.

Nisur nga përvoja e organizimit dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e shumë shoqatave në Rajonin e Venetos, kam shikuar, se shumica e tyre kanë nevojë për ripërtëritje me kuadro të reja, rishtururim cilësor dhe largim të menjëhershëm nga partitë politike, në të kundërtën rrezikojnë shuarjen e aktivitetit të tyre.

Në Kosovë, pas sa vitesh je kthyer dhe çka kishte ndryshime që kur ishe i detyruar të largohesh?

Nga Kosova jam larguar në Qershor të vitit 1995, në përfundim të vitit shkollor 1994 / 95,.... ndarja nga nxënësit ishte tepër emocionale, me sy të përplotur u përshëndetem mes vete, për t'u kthyer për herë të parë në fund të vitit 1997, në prag të fillimit të luftës,.... po, ashtu ndarja akoma më emocionale me familjen, miqtë dhe shokët, me disa prej të cilëve nuk u takuam më kurrë (ranë dëshmorë në luftën e fundit). Pa dyshim se kthimi më i lumtur në vendlindje ishte në korrikun e vitit 1999, pas përfundimit të luftës. Natën më të hareshme, gjumin më të ëmbël të jetës time e përjetova nën Tendën pranë gërmadhave të shtëpisë, nën shoqërimin e minjve e shijova aromën e lirisë së vendit tim.

E vetmja gjë që do të dëshiroja ta ktheja prapë në jetën time, është kënaqësia e asaj nate në oborrin e shtëpisë time !

Që kur ke filluar të merresh me shkrime e publicistikë?

Fillimisht me shkrime kam filluar në mënyrë periodike viteve të '90-ta, në gazetën "Bashkimi" të drejtuar nga i madhi Ukshin Hoti, pastaj në gazetën për fëmijë "Zogu i mëngjesit" drejtuar nga i ndjeri Sadri Kelmendi.

Ndërsa me shkrime të rregullta gazetareske dhe publicistike kam filluar në vitin 2010, fillimisht kam debutuar në gazetën "Bota sot", me 22. 07. 2010, me shkrimin "Kush nuk di të qeverisë është uzurpatorë", shkrim ky i ribotuar pas një muaji në të njëjtën gazetë, dhe për fat të keq të vendit tonë ende është aktual ai shkrim.

Në publikimet e tua, vërehet se je kritikues i ashpër i dukurive negative në institucionet qeveritare në Republikën e Kosovës, por edhe në partitë politike të Kosovës ?

Është tepër e vështirë të mbetesh indiferent ndaj dukurive negative. Siç e cekta edhe më sipër, shkrimi i para pesë viteve është ende aktual për vendin tonë. Qeverisja e vendit është produkt i partive politike dhe anasjelltas. Liderët e partive politike pas lufte e kanë humbur logjikën e veprimit; në vend të përkushtimit ndaj problemeve të qytetarëve më shumë janë marrë me pasurimin e tyre në kurriz të popullatës duke e trajtuar shtetin si plaçkë lufte, qytetarët si skllëvër të tyre.

Florim, të përshëndes!

Bisedoi, **Beqir M. Cikaqi**

MIRËNJOHJE ATYRE QË KONTRIBOJNË NË RRITJEN E VLERAVE NACIONALE ...

Pak dite me pare ishim te ftuar ne një veprimtari te organizuar nga shoqata At-dhetare "Malësia"

Një mjedis tepër miqësor dhe komod për te vlerësuar disa personalitete te artit dhe kulturës, te cilët me punën e tyre kane bere, te meritojnë respektin dhe mirënjohjen e te gjithë shoqërisë.

E veçanta ishte se, ata vinin nga zona te ndryshme, por edhe nga vende te ndryshme ku jetojnë shqiptaret.

Te pranishëm ne këtë veprimtari ishin. Mjeshtri Fadil Kraja, Nenprefektja e Malësisë se Madhe, zonja Taze Lohja; Kryetari i Shoqërisë se Shkrimtarëve ne Shkodër, shkrimtari Skënder Temali, Kritiku letrare Kadri Ujka, Kryetari i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Ndue Sanaj; kryetari i Shoqatës "Malësia e Madhe-Nderi i Kombit", Sytki Ndreca e mjaft te tjerë artist, këngëtar e te ftuar miq te tjerë nga gjithë krahinat e Qarkut Shkodër.

Mërgimtarët tanë, kudo që jetojnë anë e mbanë botës, janë shembull i atdhedashurisë dhe mallit të pashoq për vendlindjen e vet. Ata, e kanë dëshmuar këtë në mënyrën më të bukur përmes veprimtarive të shumta në momentet më të vështira duke i qëndruar pranë tokës së vet arbërore në çdo çast. Dashuria e këtille ndaj vendit të lindjes mund të shërbejë si shembulli më i mirë të gjithë popujve tjerë, pasi ashtu siç ka njeriu vetëm një nënë, ashtu edhe vendlindja është vetëm një. Mirëpo, ajo që duhet veçuar është edhe fakti se bashkëkombësit tanë, jo vetëm se kanë ndihmuar vendlindjen nga vendet ku jetojnë dhe punojnë, por ata me gjithë potencialin e vet, kanë vepruar që identitetin e vet nacionale ta ruajnë dhe kultivojnë në breznitë e reja, në vende të ndryshme të botës. Dëshmi e kësaj është themelimi i shoqatave dhe fondacioneve të shumta, të cilat kanë tubuar mërgimtarët tanë, që në mënyrë të organizuar, të ndihmojnë dhe të veprojnë në ruajtjen e traditës, kulturës dhe gjuhës së bukur shqipe. Përveç kësaj, ata kanë themeluar edhe media të shumta, të shkruara dhe elektronike, për të qenë më afër njëri tjetrit dhe më afër vendlindjes së vet të dashur. E bëra



Ndue Sanaj dhe Vat Ftoni, me titujt që i ka dhene këshilli i komunës Rrethina dhe Gruemire, zotit Ndue Ftonit



Kengetari Shaban Gjeka dhe N/Prefektja e Malesise se Madhe, Taze Lohja

këtë hyrje të këtitillë, e nxitur nga një ceremoni vëllazëror, i mbajtur më 18 gusht te këtij viti, në restorantin "Internacional",

ne te cilin iu nda titulli "Qytetar Nderi", nga këshillat e komunave Gruemire dhe Rrethina, si dhe mirënjohja nga Këshilli

bashkiak i Shkodrës, disa bashkëkombësve tanë nga vendi dhe që jetojnë në botën e mërgimit, në shenjë respekti për gjithë kontributin e dhënë në të mirë të pjesëtarëve të popullatës shqiptare në vendlindje dhe kudo që jetojnë në botë.

Në mesin e laureatëve të kësaj mirënjohjeje të thellë vëllazërore, ishin veprimtari i dalluar, publicist dhe intelektual nga këto hapësira Rush Dragu; pastaj biznesmeni i suksesshëm dhe njeriu i palodhur për të ndihmuar vendlindjen dhe bashkëkombësit e vet kudo që janë, Ndue Ftoni; këngëtar i mirënjohur ulqinak, Shaban Gjeka; veprimtari i njohur kulturor, Ndue Gjekaj, Kole Prek Cacaj nga Trieshi, i cili ka dhene enje kontribut te jashtezakoshem per ndertimin e kampanielit te Kishes se Madhe dhe ndertimin e Kishes ne Trieshe, e te tjere. Këta, nga Këshilli i komunës Gruemire dhe i komunës Rrethina ju është dhene titulli "Qytetar Nderi" i tyre.

"Ne vetëm se i dëshirojmë të mirën vendlindjes dhe popullit tonë, përparimit dhe të ardhmes së tij", u shpreh Rush Dragu, veprimtari i dalluar shqiptar në SHBA, me rastin e marrjes së titullit "Qytetar nderi", i cili, sa me dashamirësi po aq me emocione, përshëndeti miq, të njohur dhe përfaqësues të jetës kulturore, politike dhe shpirtërore, të pranishëm në këtë solemnitet. Ai, në veçanti falënderoi bashkëveprimtarët dhe të gjithë ata që nuk kursehen në kultivimin dhe afirmimin e vlerave tona të shenjta në të mirë të popullit shqiptar. Dragu, po ashtu, falënderoi bashkëkombësit e vet në vendlindje, në veçanti Shoqatën atdhetare "Malësia", të cilët në këtë mënyrë dëshmojnë dashurinë vëllazërore për bashkëvendësit e vet kudo që jetojnë. Ishte ky një takim sa vëllazëror, po aq i përmallshëm me bashkëvendësit tanë, të cilët jetojnë në mërgim, dhe që i njohim më tepër përmes veprimtarive të tyre të shumta duke ndihmuar vendlindjen dhe duke kultivuar vlerat tona kombëtare në vendet ku jetojnë.

Përgatiti Lulash Brigja



Veprimtari e intelektual i Rush Dragu, me titullin "Qytetar Nderi" i komunës Gruemire



Pjesëmarrës në veprimtari

ETIKA MJEKSORE



Dr. Med. Ndue Nikaj

Për etikën është e vështirë të jepet një përkufizim i saktë ose të përcaktohen vlera dhe rregulla (principe) që përcaktojnë qëndrimin e mjekut. Shoqëria u kërkon mjekteve të ndjekin një "moral". Sot është i keqinterpretuar, nga që kujton shënimet filozofike dhe i referohet një faji individual. Po ashtu shprehja "moral mjekësor" shpesh është zëvendësuar me "etikë mjekësore". Në fakt etika vjen nga fjala greke "ethos", që do të thotë "zakon" dhe nga fjala "moralis" në latinisht që do të thotë "zakon – moral", të cilat janë sinonime.

Etika mjekësore – sot vlerësohet si sjellje private dhe publike e njeriut të çdo profesioni, që gjykohet në raportin e sjelljes së tij krahasuar midis të mirës dhe të keqes në favor të principeve të mira. Nocioni etikë mjekësore sot nuk raporton përgjegjësinë personale të secilit person, në praktikën mjekësore. Për kohët e fundit përdorimi etikë mjekësore kufizohet në rregulla kolektive (gjë që e afron me Deontologjinë) ose në rregulla që përdoren në kërkimet mjekësore (që e afron) me Bio – etikën.

Si përkufizim etika mjekësore dikton rregulla, sjellje të mjekut, kur në praktikën e tij bën thirrje pacientit që balafaqohet me zgjedhje mjekësore dhe sidomos kur paraqiten rrjedhoja që është e vështirë për ti vlerësuar. Qëllimi i mjekut, do duhet të diktohet nga sjellja e tij morale që mbetet e njëjta: - të bëjë mirë sa të jetë e mundur me çdo mjet: dhe në të njëjtën kohë "të mos bëjë keq" sipas shprehjes Latine "Primum non nocere", "në radhë të parë mos dëmto". Në pamje të parë gjithçka duket e thjeshtë, por paraqitja të gënjen, të mashtron. Nga që çështja shtrohet të dihet çfarë kriteresh janë të lejuara në shoqëri për të garantuar se behet mirë. Teoritë që disponohen për ti dhënë përgjigje kësaj pyetje: Disa i referohen një ideali shumë më të lartë, të tjerët i drejtohen një identiteti të përkryer, një hyji transcendent (një mendje hyjnore) burim i rregullave të sjelljes njerëzore dhe një grup: tjetër vlerësojnë në mënyrë pragmatiste duke u nisur nga rezultatet.

Për mjekun; nuk bëhet fjalë të për-

doren teori; për ti jepet përgjigje kësaj çështje rast pas rastit dhe konkretisht duke marr konsensus (pëlqimin) e pacientit për çfarëdo procedure të përdorur.

Për ata ka rëndësi të zgjidhet e keqja më e vogël, do të thotë të pakësohet dhimbja, vuajtja, kjo nuk do të thotë aspak se mjeku nuk ka asnjë bindje morale ose nuk kërkon të praktikojë një model.

Sidoqoftë veprimtarit kërkimore dhe klinike do ti nënshtrohen një shumice kriteresh praktike, që janë ligje dhe aplikime profesionale të kolegeve bashkëpunues dhe të palëve ndërvepruese.

Mjeku po ashtu është i detyruar të bëjë llogaritë e zgjedhjeve të veta në funksion të eksperiencës personale shkencore duke përpunuar strategji për të zvogëluar vuajtjet.

Etika dhe ligji

Mjeku u bindet ligjeve ose rregullave që vendos shoqëria ku jeton. Pra si aplikon ligjet etikë mjekësore në sensin juridik të temës: kodi i shëndetit publik, dekretet ministeriale, rekomandimet protokollare etj. duke u mbrojtur kështu nga rreziqet në proces. Ligjet, megjithatë nuk është e lehtë për ti përdorur (aplikuar) dhe mund të ketë vend për konflikt në koshjencën dhe eksperiencën e mjekut. Për natyrën e vet normative nganjëherë frenohet çdo iniciativë personale, gjë që çon dhe në kategorizimin e të sëmurëve duke i izoluar ato (si në kuti) e duke i konsideruar ato si objekt dhe jo si subjekt (person) që vuan. Në anën tjetër shkenca funksionon pa ndërprerë me mjete të reja diagnostiko dhe terapeutike.

Sot janë krijuar situata të pa imagjinuara më parë, por ama po veprohet për ditë në botën moderne si: trapiantet (transplantimet e organeve), vendosja e protezave valvulare artificiale, protezave të gjurit, koxo – femorale, By-pass koronare, angioplastike me vendosje të stendave e te tjera kontrolli i riprodhimit ose manipulimet sipas hartës gjenetike të njeriut (gjenomës humane). Për ketë duhet që rregullat dhe ligjet të ripërtërihen dhe të jenë koherente, të mos vjetrohen, sepse mjeku ka detyrë të bëjë më të mirën për pacientin, ta bëjë cilësisht mirë dhe brenda këtij kuadri të mos gjendet jashtë ligjit.

Kur propozohet përdorimi i qëndrimeve të reja në shumë raste ajo mbështetet nga komisionet e etikës ose komitetet konsultative për të mbrojtur personat për kërkimet bio – mjekësore (komisioni bio – etikë).

Përball një rasti konkret mjeku ngrenë çështjen në se për këtë person duhet t'i referohemi principeve të përgjithshme që lënë hapësirë veprimi apo të ndiqen dekretet e ligjet e shkruara. Në fakt teksti nuk mund të qeveris etikën e mjekut, nga që ato janë të ngurtë, shpesh të vështirë të shqyrtohen, të kufizuar dhe lënë vend për hipokrizi mjeko – ligjore.

Një shembull i vështirësive është marrja e konsensusit (pëlqimit) të pacientit në se donë të mbrohet nga rreziku i procedimit (gjykimit) e i dënimit, pra për këtë ai (mjeku) duhet të informojë pacientin

(të sëmurin) me shkrim ose në prani të familjarëve ose personave të tretë (si dëshmitar), kështu një urografi intravenoze me "Lipjodol" për veshka mund të paraqes një rrezik vdekje – prurës (qoftë dhe minimal) nga reaksioni alergjik ndaj jodit, që ka kontrasti për të paraqitur imazhin radiologjik të aparatit urinar. Mirëpo qëllimi etik nuk është të risi ankthin e pacientit, por të vendosi një marrëdhënie besimi, të dëgjoj dhe të kuptojë dhe të shpjegojë nevojën e këtij ekzaminimi dhe të vlerësojë shqetësimet e tij dhe të mos i shkaktojë atij frikë për eventualitetin e një ndodhie si përjashtim. Në këtë rast mund të merrret një vendim për ta shtruar 2 – 3 ditë të sëmurin sa të qetësohet pas bërjes së kësaj urografe. Efikasiteti i marrjes nën kujdes dhe trajtimi adekuat është më mirë, kur pacienti është i bindur për vendimin e marr dhe ligjet nuk ndryshojnë asgjë.

Etiket dhe parat

Zgjedhjet ekonomike ndërhyjnë në ndërgjegjen e mjekut dhe të personelit të shëndetësisë. Në sferën ekonomike etika mjekësore e bazuar mbi vendimet personale u kundërvihet vendimeve kolektive. Ajo është në veçanti e përballur me zgjedhje politike, të mjeteve ekonomike, të shëndetësisë për t'iu atribuar buxhetit, për të ndërhyrë; në politikën shëndetësore të përditësime.

Në se është e logjikshme, që mjeku të inkurajohet të bëjë llogarit e shpenzimeve të trajtimit dhe të ekzaminimeve suplementare, që përshkruan, duhet në çdo rast të bëhen llogarit ekonomike për kujdesin ndaj pacientit ose ndaj grupit të pacientëve duke marr parasysh rreziqet e këtyre të fundit, që mund të çojnë në kufizimin e shanseve për shërimin e tyre.

Disa zgjedhje janë të dhimbshme, kështu për arsye buxheti disa trajtime shumë të shtrenjta nuk mund të realizohen nga çdo pacient. Kështu është vendosur nga komisionet mjekësh në emër të shoqërisë të cilët do të jenë ata të sëmur, që do përfitojnë si: "më të rinjtë", ato që nuk kanë sëmundje të renda shoqëruese, pra mjekët llogarisin moshën, gjendjen shëndetësore dhe prognozën e sëmundjes. Kjo është e domosdoshme për një farë kohe pak a shumë të gjatë, për gjithë terapitë e reja, të cilat nuk mund të përhapen menjëherë në çdo vend. Kjo është dramatike dhe e vështirë të kuptohet dhe të pranohet nga shoqëria si p.sh: një i moshuar nuk përfiton kujdesin më të mirë të mundshëm nga që kjo metodë ka kosto të shtrenjtë për shoqërinë, por kjo do të ndodh shpesh për arsye të propozimeve gjithnjë në vazhdim të mjeteve të reja terapeutike që kushtojnë shtrenjtë dhe nuk përballohen.

Etika mjekësore zakonisht reklamon kujdes për çdo pacient, sipas të dhënave aktuale shkencore dhe imponon një "detyrim për mjete" për mjekun përball çdo të sëmuri që gjendet seriozisht në pikëpyetje (para problemesh shëndetësore). Pra do duhet të përpunohen pa dyshim rregulla të reja etike në përputhje me bashkësinë shoqërore; për të fiksuar

rregulla e kriteret për çdo rast, që të përdoren të njëjtat principe të etikës mjekësore dhe nuk është "thjeshtë dialog" midis të sëmurëve dhe mjekteve.

Pra problemet e etikës e të Deontologjisë janë të lidhura dhe me historinë e mjekësisë. Në Indinë e lashtë në veprën "Caranka sanihita" thuhet : - "Mund të ndrydhesh dhe të kesh turp nga babai, nëna, nga miqtë dhe nga mësuesi; por jo nga mjeku... se ai për të sëmurin është nëna dhe babai, mik dhe vëlla"... Në papirus të vitit 2700 para Jezus Krisht (J. C) jepen këto tipare morale për njeriun e mjekësisë : - "Tipare të radha, të jetë i mirë, i zgjuar, i durueshëm, të mos ketë frikë nga gjaku dhe as nga kufomat".

Në Greqinë antike dhe në Romë ka pasur shumë punime për etikën mjekësore dhe "Deontologjinë", por betimi i Hyppocratt-it 500 vet para Krishtit (J. C) vlerësohet si kod i vjetër i Deontologjisë që nuk ka humbur vlerën as sot me këtë përmbajtje të shkurtër: "Beto hem se të sëmurëve nuk do tu shkaktoj asnjë dëm apo padrejtësi... Nuk do tu jap lëndë vdekje-prurësi dhe nuk do t'u tregoj rrugën për një veprim të tillë... nuk do të kryej aborte (dështime). Do të ushtroj profesionin me pastërti... Në çdo shtëpi do ti shërbej të sëmurit pa bërë dem... Do të respektoj fshehtësinë mjekësore (sekretin profesional), për çdo gjë që shoh e dëgjoj, nuk do ta përhap, duke u mbajtur të fshehtë"...

Tiparet kryesore të etikës mjekësore në shoqëritë demokratike mbështeten në parimet themelore morale të vendeve të përparuara si: puna me ndërgjegje të lartë dhe përkushtim. Marrëdhënie sa më njerëzore midis të sëmurëve dhe personelit të shëndetësisë, thjeshtësia dhe modestia në jetën shoqërore dhe vetjake; solidariteti, delikatesa, qëndrimi i vëmendshëm në marrëdhëniet me të sëmurët dhe familjarët e tyre. Sot etika dhe deontologjia mjekësore njihet dhe organizohet si në gjithë vendet e tjera të botës dhe tek ne "Urdhrin e MJEKUT" që u krijua ne 1993 ku filloi të vihet në jetë me anë të betimit të Hyppocrat-it (i cili bëhej formalisht dhe me pare) si më poshtë:

"Në prani të profesorëve të mijë të kësaj shkolle, të kolegeve të mijë dhe para shenjës së Hypokrat-it; unë premtoj të bëhem dhe të jem besnik i ligjeve dhe i ndershmërisë në ushtrimin e profesionit të mjekut... Do jap, ndihmë falas për të varfrit dhe nuk do të kërkoj kurrë pagesë mbi atë që vlen puna ime. Duke hyrë në intimitetin e shtëpisë, sytë e mijë nuk do shohin atë që ndodh, gjuha ime do të ruaj sekretin që më besohet dhe sjellja ime nuk do të sjell dhe nuk do të favorizoj krimin. Duke respektuar dhe duke shpreh mirënjohjen ndaj profesorëve të mijë; unë do tu mësoj fëmijëve të tyre atë që kam mësuar prej prindërve të tyre. Të më nderojnë njerëzit në se jam besnik i premtimeve të mia".

Profesioni i mjekut është sa i nderuar; po aq dhe i vështirë, ai duhet të karakterizohet nga disa virtyte si : humanizmi, mirësia, ndjenja e ngrohët dhe vetëmo-

huese. Puna e mjekut veç të tjerash është një profesion që shtron kërkese shumë të larta si ndaj mendjes dhe ndaj zemrës së tij. Këto shtrohen në betimin e GJENEVE- s të vitit 1983: “-Marr angazhim solemn se do të ve jetën time në shërbim të njerëzimit... Do të ushtroj artin tim mjekësor me ndërgjegje e dinjitet. Do të konsideroj shëndetin e pacientit tim si preokupim kryesor. Do të respektoj sekretin e atij që ma beson, bile dhe pas vdekjes së pacientit. Do të ruaj nderin dhe traditat fisnike të profesionit mjekësor. Kolegët e mijë do jen vëllezërit e mijë. Nuk do të lejoj që konsiderata fetare, kombëtare, racore, partiake ose klasore të ndikojnë në kryerjen e detyrës ndaj pacientit. Do të ruaj respektin absolut për jetën njerëzore edhe sikur të jem i kërcënuar nuk do të përdor njohurit e mia mjekësore kundër ligjeve të njerëzimit”. Kodi i Gjenevës **Betimi**

Po ashtu do të kemi parasysh deklaratën e Lisbonës për të drejtën e të sëmurëve – për të zgjedhur në mënyrë të lirë mjekun, për të refuzuar një mjek të caktuar, për të ruajtur sekretin e sëmundjes së vet; për të vdekur me dinjitet, për të pranuar ose refuzuar një ndihmë shpirtërore morale ose fetare. Në kodin e Deontologjisë Neni 11, thekson tekstualisht: “Mbajtja e Sekretit profesional në interes të të sëmurit është e detyrueshme për gjithë njerëzit e shëndetësisë”, po ashtu në Nenin 294 të kodit Penal të Republika e Shqipërisë, mos mbajtja e këtij sekretit ose e kësaj të fshehte dënohet me gjobë dhe burgim deri në 5 vjet.

Në kongresin e fundit të Shoqatës ndërkombëtare “Mjekësia dhe ligji” thuhet : “Një mjek që nxjerr në shesh një sekret profesional vullnetarisht është fajtor dhe shkel betimin e Hyppocatt-it si mjek; por po të japi të dhëna me interes për shoqërinë, mjedisin sipas kërkesave ligjore nuk ngarkohet me faj”. Për sa i takon të fshehtësë ndaj vetë pacientit, Konventa Ndërkombëtare e Gjenevës e vitit 1987 duke prekur të drejtat dhe detyrat e ndërshjellat mjek – pacient; - kodi Deontologjik i njehtë të drejtën që çdo pacient pas vizitës mjekësore të informohet për sëmundjen e tij, për prognozën (të ardhmen; perspektivën) e saj me trajtimin që merr.

Për këtë në botë ka disa qëndrime. Qëndrimi i parë: 1. Vënia në dijeni të plotë pa asnjë rezervë të pacientit dhe të familjarëve, kjo për sëmundjet dhe traumat jo të renda; ndërsa për sëmundje të renda me perspektivë të rezervuar, pacientit nuk do të marr vesh të vërtetën dhe duhet të mbahet me shpresë deri në fund, sido që është gënjeshtër, sipas Botkin kjo është “Gënjeshtër e mirë”, nga që është një akt jo imoral, por në interes të pacientit që shpreh dimension njerëzor, gjeneron shpresë, ku “shpresa është doktori më i mirë në botë”. Sipas shprehjes Latine “Dum, spiro, spero” (Sa të kem frymë kam shpresë). Qëndrimi i dytë që i kundërvihet qëndrimit të parë (më sipërm) që i përmbahen Anglosanksonët (Anglo-amerikanët) për të sëmurët rëndë dhe të pa shpresë, pra që dhe kjo

kategori duhet të njohë gjendjen e vet reale shëndetësore pa asnjë të fshehtë e gënjeshtër, sepse nuk është normale të gënjesh dhe herët a vonë i sëmurit do ta marr vesh, të vërtetën.

Qëndrimi i tretë : është një qëndrim i ndërmjetëm ku kodi deontologjik shpeshhet...”Mjekut i lejohet kur e sheh të arsyeshme të mos i tregojë të vërtetën për diagnozën dhe prognozën e një sëmundjeje me ecuri të keqe dhe vijon në nenin 40...”Prognoza fatale e një sëmundjeje në rast se thuhet, duhet të formulohet me shumë kujdes e takt. Për këtë, sidoqoftë duhet dijtë dhe familja ose persona të tjerë, kur atyre u besohet nga familja...”

Mjeku dhe konsulta mjekësore vendosin duke u mbështet në gjendjen psikologjike të çdo pacienti të veçantë; mund ti thuhet me shumë takt e kujdes diçka për sëmundjen për ta përgatitur atë gradualisht për gjendjen tij të rëndë, duke u paraqitur i gatshëm për bashkëpunim në çdo kohë, për të bërë gjithçka mundën për të mbijetuar, po kështu dhe për familjarët, sepse e kanë shumë të vështirë të përshtaten me ecurinë fatale të afërmit të vet të shtrenjtë, shpesh ato reagojnë me ashpërsi duke u konfliktuar me mjekët; duke i akuzuar për mjekim të pa kujdesshëm deri në gjykata. Për këtë është detyrë e personelit mjek-infiermier të jenë gjithnjë të durueshëm, duke u përpjekur të bëjnë më të mirën; çdo gjë sipas personit e nivelit të tij.

Në literaturën botërore publikohet rasti i një gruaje para një profesori të madh – pas operacionit – në të dhënat anatomo-patologjike të tumorit të gjirit, kur profesori po i jepte përgjigjen – ajo e pyet... po tash pas kësaj dhe sa më ka mbetur të jetoj? Profesori i thyer në moshë pasi u mëndu i tha : zonjë sa të jem gjallë unë ti nuk do vdesësh. Ajo ju hodh në krah profesorit dhe e përqafoi, të cilit iu kujtua shprehja latine “Dum, spiro, spero” (Sa të kem frymë, shpresoj)

Pra siç shihet etika mjekësore është e lidhur direkt me bio-etikën që përbën tërësinë e rregullave që e cituam më sipër që aplikohen në të gjitha fushat shkencore të jetës? Detyrat morale dhe të drejtat në ushtrimin e profesionit të mjekut si në betimin e Hyppocrat-it që u përmend etj. Në vitin 1976 Asambleja parlamentare ose Komiteti i Ministrave të jashtëm të vendeve pjesëtare llogariten aspektin etik të shkencës mjekësore dhe aspekte të veçanta të individit.

Në vitet 80 u bënë rekomandimet për të drejtat e të sëmurëve, në fillim të viteve 90 u fut nocioni i depistimit gjenetik dhe lejimi i kërkimeve mjekësore në embrione.

Në 1992 Komiteti Evropian e bio-etikës u pagëzua si Komiteti Drejtues për bio-etikën i K. Evropian (C. D. B. I) i përbërë nga mjek, filozof, jurist, shkencëtar dhe anëtar të asamblesë Parlamentare të: “mbroj qenien humane në identitetin dhe dinjitetin e vet”.

DOLI NUMRI DHJETË JUBILAR I REVISTËS MALËSIA

Doli nga botimi numri 10 jubilar i revistës për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore Malësia, në Podgoricë, Mali i Zi, i cili sjellë rreth 50 artikuj shkencorë, recensione, vështrime dhe përrurime. Në këtë numer kanë bashkëpunuar studiues nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Kroacia, Bullgaria, Italia, Suedia, Gjermania, Austria, Rumunia dhe Mali i Zi.


Në rubrikën “kulturë” punimet e veta i kanë prezantuar 31 autorë: **Akademik Aleksandër STIPÇEVIQ** “Etnogjeneza e shqiptarëve nga ilirët”; **Prof. dr. Anton Nikë BERISHA** “Mbi pasthëniet e Pjetër Budit në “Doktrinën e krishterë” dhe në “Ritualin romak”; **Prof. dr. Shefkije ISLAMAJ** “Tribuna të mëdha të filologjisë shqiptare: “Studime filologjike” dhe “Gjurmime albanologjike”; **Pof. dr. Valter Memisha**” Ndiheza shkencore e akademik Shaban Demiraj në faqet e revistës “studime filologjike”; **Akademik Gjovalin SHKURTAJ** “Ndiheza e Prof. Mahir Domit në lëmin e dialektologjisë dhe të onomastikës shqiptare”; **Prof. dr. Matteo MANDALÀ** Letrat e pabotuara të Mitkos për Kamardën: shënime paraprake për botimin e tyre”; **Prof. dr. Tomor OSMANI** Preng Doçi themelues i shoqërisë “Bashkimi” dhe ndihmesa që dha ajo për njësimin e alfabetit të shqipes”; **Prof. dr. Shaban SINANI** “Një lexim etnografik në letërsinë e I. Kadaresë- Me një vështrim të posaçëm në veprat Çështjet e marrëzisë dhe Konkurs bukurie për burrat në Bjeshkët e Nemuna -”; **Prof. dr. Hajrullah KOLIQI** Anton Harapi për vëllazërimin ndërshtetërisht; **Prof. dr. Zymer Ujkan NEZIRI** Mbledhja dhe botimi i eposit të kreshnikëve nga krahina e Trieshit: kontributi i Nikollë Ivanajt”; **Dr. Xhavit BEQIRI** Fishta dhe “Lahuta”; **Prof. dr. Mustafa IBRAHIMI** Njësi frazeologjike me gjymtyrë emra vendesh”; **Prof. dr. Roland ZISI** Himara në veprën poetike të Jeronim de Radës”; **Prof. dr. Josif MITA** Për përshtatjen sintaksore”; **Prof. dr. Adem ZEJNULLAHU** “Drama e një balade familjare”; **Dr. Fiorella DE ROSA** Rreth disa veçantive gjuhësore dhe letrare të teksteve folklorike të Fallkunarës të botuara në revistën “La Cabria” (1888-1902); **Prof. as. dr. Muharrem JAKUPI** Modernizmi në prozën shqiptare dhe filimet e ligjërit në brendshëm në romanet Ismail Kadaresë”; **Dr. Anila ÇEPANI - dr. Rozana RUSHITI** Vështrim historiko-krahasues i toponimeve të ndryshuara në 100 vjet”; **Dr. Kastriot MARKU** Teksti letrar si monument dhe shkrimi i historisë së letërsisë shqipe”; **Dr. Edlira TROPLINI** “Dukuri të hershme gjuhësore në të folmet e diasporës shqiptare”; **Dr. Anisa KOSTERI** “Prurje gjuhësore të dy dialekteve në prozën artistike të Adem Demës”; **Dr. Ema KRISTO** “Përdorimi i fjalëve brizante në gjuhën e politikës në Shqipëri - Një vështrim mbi karakteristikat e tyre -”; **Doktorant Anton GOJÇAJ** “Poema epike në Ballkanin Perëndimor (vështrim krahasues); **Mr. Marina MIHAJLOVA** “Ditari i Bedi Pipës”; **Doktorante Monika HASANI** “Vështrim leksiko-semantik i grupit paradigmantik të përavrave të pacaktuar”; **Doktorant Erzen KOPERAJ** “ Pjesoret me -m tek autorët veriorë të shekujve XVI-XVIII”; **Doktorant Fitor OLLOMANI** “Fjala e artit poetik të Ali Podrimjes”; **MA Besa HOXHA-BEQIRI** “Historia e letërsisë e Justin Rotës”; **Doktorante Evalda PACI** “Fjalori i Frang Bardhit në një kontekst të historisë së shkrimit të shqipes”; **MA Eriola AGALLIU (PHD Folloëing)** “Gjeografia dialektore në romanin Me valët e jetës të Vedat Kokonës”; **Avdyll SULAJ**, studiues “Lirika popullore – shtojzovalja e folklorit shqiptar”.

Në rubrikën nga “histori” janë prezantuar shtat (7) studime shkencore: **Prof. dr. Zef MIRDITA** rishkrimi ndërshtetërisht - riti ortodoks”; **Prof. dr. Emine BAKALLI** “Idea evropiane: Kongresi I i Unionit Panevropa dhe shqiptarët”; **Prof. Dr. Lush Culaj** «Diplomacia austro-hungareze për kryengritjen shqiptare të Malësisë së Mbishkodrës të vitit 1911”; **Prof. asoc. dr. Nertila HAXHIALJARJA** “Rilindja e kishës katolike shqiptare”; **Prof. asoc. dr. Gjon BERISHA** « Identiteti arbëror i Zetës: kontinuiteti iliro-arbëror i Dioklës (Zetës)”; **Dr. Edmond MALAJ** “ Familja fisnike shqiptare Engjëlli (Angelus) para pushtimit osman: mbi origjinën dhe gjenealogjinë e familjes Engjëlli”; **Doktorant Eduard NDRECA** “Mirdita në kryengritjen antiosmane të vitit 1911”.

Në rubrikën “recensione” janë prezantuar po ashtu shtat (7) vështrime për disa botime aktuale të autorëve nga Italia, Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Suedia, trajtuar nga Prof. Dr. Anton Nikë Berisha, Prof. Dr. Shaban Sinani, Prof. Dr. Fatbardh Hoxha, Prof. Gjokë Dabaj, Mr. Sheremet Krasniqi dhe Hysen Ibrahimia.

Ky numer mbydhë me vështrime dhe urime për revistën Malësia, nga kryeredaktorët e disa rivistave të njohura shkencore, nga drejtuesit e institucioneve universitare, akademike dhe shkencore, si dhe nga intelektualë të tjerë të njohur të shkencës e kulturës shqiptare, sikurse janë: prof. univ. dr. Ardian Kyçyku, bashkëthemelues dhe bashkëdrejtues i revistës europiane *Haemues*, gjithashtu Rektor i Universitetit Rumun të Shkencave dhe Arteve *Gheorghe Cristea* në Bukuresht dhe President Ekzekutiv i *European Academy of Performing Arts*, Bukuresht, Rumuni; prof. dr. Valter Memisha, kryeredaktor i revistës *Studime filologjike* dhe drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë; prof. dr. Lulëzim Lajçi, kryeredaktor i revistës *Gjurmime albanologjike* - seria e shkencave historike, Prishtinë; prof. dr. Fatbardha Hoxha, kryeredaktore e revistës “Buletini shkencor” dhe drejtore e Institutit të Studimeve Albanologjike të Universitetit të Shkodrës „Luigj Gurakuqi”; prof. dr. Simë Gjon Dobreci, kryeredaktor i revistës *Buzuku*, Ulqin; z. Anton Marku, ideator dhe themelues i revistës *Dielli Demokratian*, Vjenë; prof. dr. Anton Nikë Berisha, Universiteti i Kalabrisë; prof. dr. Lush Culaj, Instituti Albanologjik, Prishtinë; prof. asoc. dr. Muharrem Jakupi, Universiteti *Aleksandër Moisiu*, Durrës.

Themelues dhe kryeredaktor i revistës është Nikë Gashaj, email: *malesia@t-com.me*; *nik.gasaj@gmail.com*



Frederik Rreshpja, poetin, që e mbyllin jetën në një libër...

NË KUADRIN E 75 VJETORIT TË LINDJES

Frederik Rreshpja, në pamje të parë, mund të duket një poet jashtë rrjedhave. Ky mendim krijohet duke parë botimet e dy dekadave të fundit, mirëpo, po t'u hedhësh një sy librave të rinisë së tij, kuptohet se sa e rëndësishme ka qenë për këtë poet krijimtaria poetike e Ismail Kadaresë, edhe pse tregonte një talent të veçantë në shumë drejtime.

Duhet thënë se shumë motive dhe qasje ndaj tyre të kujtojnë poezitë dhe qasjet poetike të atij që shihej si poeti më i suksesshëm i kohës. Në mendimin zyrtar të viteve '60-të, kohë kur u shfaq së pari poeti Rreshpja, suksesi shihej te tematika, diçka që ilustruhet me emrat e Lazar Siliqit, Ismail Kadaresë, Dritëro Agolli, Fatos Arapit e te tjere. Si poet i ri që kërkon suksesin, Rreshpja bëhet pjesë e këtij modeli, duke ia arritur qëllimit që i kishte vënë vetes, sepse poema "Topi fushor" hyn në antologjinë më të rëndësishme zyrtare të kohës, pa botuar më parë ndonjë përmbledhje poezish më vete. Në përmbledhjen e parë (1968), këtë "haraç" do ta gjejmë te poezitë e poemat për partizanin, heronjtë e punës socialiste, aksionistët, lapidarët, ushtarët e revolucionit, ndërsa në përmbledhjen e dytë (1973) do ta gjejmë te poezitë e poemat për komisarin, hidrocentralet, 8 Nëntorin, 1 Majin e te tjere, gjithmonë duke pasur parasysh se, me anën e realizmit socialist, poezia shqipe po njihet ndikimet futuriste dhe postfuturiste, sidomos nga ndikimi majakovskian. Titujt e përmendur tregojnë se përfaqësojnë tematikën tipike të poezisë së kohës, por, gjithashtu, edhe formën shkrimore.

Megjithatë, edhe kjo periudhë e krijimtarisë, përshkohet nga kontradikta midis talentit të mirëfilltë poetik dhe sloganizmit të diktuar ideologjik. Vetëm kur shmangim shtresat soc-realistike të këtyre dy vëllimeve të para poetike, ndodhemi përpara zbulimit të Reshpjes si poet që u qëndron kohëve. Shohim se në disa fragmente poemash e poezish, ku u ikën temave të imponuara, duke ndërtuar zërin unik të poetit, pamjet e thjeshta të sendeve të ngrihen deri në simbole, prej nga bëjnë të dukshme e të prekshme forma të tjera më të fshehura e më të përkryera: një ndjesi që bëhet mbizotëruese në periudhën e dytë të krijimtarisë, ku duhet të flasim me një gjuhë tjetër, sepse tashmë kemi çliruar nga kompleksi tematik.

Por le të rrimë edhe pak në kohën për të cilën po flisnim. Në një shkrim redaksional të revistës "Nëntori", të vitit 1973, me titull "Probleme të poezisë sonë" dhe nëntitull "Kundër ndikimeve të huaja në poezi", ku flitet për një diskutim krijues të marsit të atij viti në Lidhjen e Shkrimtarëve të Shqipërisë, gjejmë edhe këto rreshta – Rendja pas figu-

rave e ka çuar ndonjë poet gjer atje sa të spostojnë mendimin dhe të nxjerrë figurën në plan të parë. Kjo e bën poezinë të tingëllojë krejt formaliste. Ja një shembull i tillë: *Mane të varrosën në muz / Kali yt që u bë vjeshtë / Hëngri gjelbërimin e pyllit / Dhe befasi u bë dimër.*

Poezia në fjalë mbyll periudhën e parë të kësaj krijimtarië dhe shërben si hallkë lidhëse për atë që do të ringjallet pas 17 vjetësh, në kohën e quajtur të demokracisë, sepse për gjithë këtë periudhë kohore poetit do t'i privohet liria dhe e drejta e botimit nga regjimi i kohës. Kjo pikë e zgjedhur na shërben për të parë se, paradoksalisht, këto dy periudha krijimtarie do të kenë si dallime, ashtu edhe të përbashkëta po aq të mëdha. Pra, vetëm vitet '90-të dhanë atë liri që i shërbeu gjetjes së zërit të mirëfilltë të poetit, krijimtarisë që ngjizet në bazë të ligjërive të brendshme, pa ndikim nga jashtë.

Ndryshe nga krijuesit e tjerë të brezit të vet, Frederik Rreshpjen e karakterizon pakënaqësia nga efektet e lehta e zgjidhjet gjysmake, për hir të një vepre serioze dhe të mundit e të djersës që kërkon ajo. Mbetet mbase i vetmi poet i brezit të tij që nuk ka tentuar asnjëherë për të ribotuar në vitet '90-të pjesën e parë të krijimtarisë së tij, por nga krahasimi i teknikave të realizimit të vargut shihet se ajo periudhë e krijimtarisë i ka shërbyer si "fletore ushtrimesh", duke çuar përpara cilësitë e veta më të mira në këtë drejtim.

Ai të kujton Kavafin, si poet që në një moment pjekurie kap thelbin e asaj që duhet të jetë krijimtaria e tij e ardhme. Më tej, të kujton Malarmenë, si poet që nuk i lejon vetes asgjë të rastësishme, sado e bukuroftë ajo, sepse çdo gjë duhet të mbizotërohet deri në fund.

Ndryshe nga ç'kishte qenë moda e shekullit XX, ai i përket klasës së poetëve që kërkojnë ta mbyllin jetën e vet në një libër. (Gjatë këtyre viteve i botohen mbi dy - tre vëllime, por ato mund të shihen si variante të të njëjtit libër, të cilat mbartin dhe transmetojnë zejen gjithnjë e më fine të një poeti të karakterizuar nga pakënaqësia e përgjeshme për punën e vet.).

Nga periudha e parë e krijimtarisë, megjithëse tingëllojnë cinike, ai mbart vetëm strofën e lartpërmendur, ku u cilësua si "formalist", e cila nuk qe përfshirë nga dy librat e parë, por qe e botuar në një revistë kulturore të kohës. Këto vargje, që përcaktojnë gjithë kuturisjen e ardhshme poetike, na ndihmojnë të kuptojmë se bërthama e tematikës dhe e teknikës së ardhme i ka rrënjët te periudha e parë, që u ndërpre në mënyrë të dhunshme.

Nga ana tjetër, këto vargje na kujtojnë se sa e rëndësishme qe për këtë poet krijim-

taria popullore. Ato japin disa prej veçorive që ka përdorur ky poet në raport me krijimtarinë e popullit.

Këto veçori mund t'i rendisim në:

- apostrofimet e shpeshta: Mane të varrosën në muz / Kali yt që u bë vjeshtë

- rimat s'kanë rëndësi (ato mund të jenë të rastit): në rastin konkret, duke pasur parasysh një strofë klasike katërshe, nuk rimojnë as muzg me pyllit, as vjeshtë me dimër, megjithatë ne as që ndiejmë ndonjë mungesë

- metrika s'ka shtrëngesë:

vargu i parë ka 9 rrokje, vargu i dytë ka 8 rrokje, vargu i tretë ka 9 rrokje, ndërsa vargu i katërt ka 7 rrokje

- nënlloji i baladës: poezia ka tipologjinë e këtij nënlloji poetik

- karakteri i gjamës: poezia përcjell jehonat e largëta, por të përpunuara të kësaj pjesë të krijimtarisë popullore, një shembull të së cilës po e citojmë: I mjeri u, mik e ma i miri mik, i mjeri! / Kur t'nisesh me dalë prej ksaj shpi, / Lamtumirë thuej, mal e vrri, / Lamtumirë, shokë e miqsi

- mbështetja në krijimtarinë popullore dhe përpunimi mjeshtëror: poezia na kujton një krijim popullor, por që tejkalohet në sajë të mjeshtërisë së një poeti modern, i cili e ka vetëm si bazë motivin e caktuar popullor

- shfrytëzimi i elementeve piktorike përpara atyre tingëllore: duke përdorur gjuhën kritike të Kutelit, do të thoshim se poezia e Reshpjes është më tepër një poezi e syrit sesa e veshit, një premisë më tepër për të përfunduar idenë e raporteve të saj me folklorin shqiptar.

Mirëpo, nga ana tjetër, poezia e Reshpjes dominohet nga metafora, e cila, siç thotë Pipa, kur flet për Migjenin, nuk është karakteristike e poezisë shqipe, sepse në poezinë shqipe zakonisht është shpjeguese dhe ilustrative, e afërt me krahasimin. Shqiptarët që priren të jenë realistë dhe praktikë, anojnë kah një stil diskursiv, pa kalime te dhunshme apo kontraste të thella...

Rreshpja përleq metaforën paralogjike. Shikon tek ajo fuqinë e njeriut, duke na kujtuar fjalët e Ortega Y Gasset se ajo afrohet me magjinë dhe, si instrument i krijimit, është harruar prej Zotit në brendësinë e krijesave të veta...

Pas metaforave që përdor Rreshpja kemi humbjen e botës objektive, por bota e "krijuar" prej tyre tregon fuqinë e fituar, duke marrë kujtimin e një pasqyre vërtetë të veçantë të saj. Na vjen ndërmend koncepti bodlerian se e çrregullta, domethënë e papritura, e befta, habia, përbën një element thelbësor të së bukurës, cilësi këto në fakt të barokut.

Por, duke shkuar përtej poetëve barokë, ku bashkohen më anë të arsyes dy ele-

mente të pavarura, shumë shpesh ai u heq pavarësinë edhe elementeve që bashkon, duke krijuar një element të tretë, diçka që është vetë simulakra bodlilariane. Me anë të një procesi të thjeshtë gjuhësor, metafora ngrihet në nivelin më të lartë të ndërlkueshmërisë poetike. Te Rreshpja ajo na shfaqet si:

a) brenda një shoqërimi fjalësh njëra humbet kuptimin e zakonshëm dhe përdorimi i ri fiton një

informacion më të madh kulturor, si në format – "folklori i zogjve; / itakat e legjendave; / shtëpia e gjetheve"

b) animizim i natyrës (metaforë folje), si në format – "fshihet era në legjendë; / hëna vizaton; / shqetësohet zogu i pritjes; / flenë stinë; / vallëzon mermeri i legjendave"

c) krahasim që bëhet në mendjen tonë, përtej krahasimit të zakonshëm, si në format – "reja gri si mall i harruar; / dëbora si një perëndi ilire / ..."

ç) metaforë epitet (epitet metaforik), si në format – "druri i trishtuar; / dëbora e thinjur; / hëna e pikëlluar"

d) nga kuptimi i ngjashmërisë, si në format – "unë kam qenë trishtimi i botës; / një mjegull quhet: akuarel i lëvizshëm / ..."

Kemi edhe disa cilësi të tjera të poetikës manieriste dhe baroke te ky poet, ku rreshtojmë:

a) katakrezë – "mermeri i thyer i Perëndisë së Humbjes; / kënga e artë e lamtumirës"

Epitetet i thyer, e artë rigjallërojnë disa forma që po shkojnë drejt gjuhës së folur.

b) oksimoron – "o e verbra madhështore; / o fat budalla; / një kalë i vdekur vrapon nëpër shpat; / rri sonte te unë sa të bëhen trëndafilat e drurëve të vdekur;"

Është e qartë për të gjithë se bashkimi i veçantë i fjalëve ka shmangur kuptimin e njohur të dy elementeve që përplasen, pasi nuk logjika nuk e pranon të vrapojë një kalë i vdekur.

c) Sinestezia – "Megjithatë e di: erdhi një trëndafil me shall / Dhe ishte një vajzë që çeli gjethe tek porta ..."

Shohim të priten dy rrafshes ndjesore, të cilat e nxjerrin lexuesin nga një ndjeshmëri e zakonshme.

Ngatërrimi i sferave të ndijimit bëhet qëllim estetik i poezisë.

Duhet të theksojmë se, edhe pse të kujton poetikat manieriste e baroke, kjo poezi ruan vlerën e modernitetit që në letërsinë perëndimore ka filluar me pohimin e fuqisë interpretuese të gjuhës në poezi (Poe, Hopkins, Mallarmé), kur ajo fiton domethënie e përmasa të reja në shtratin e poezisë bashkëkohore.

NGA DR. GAZMEND KRASNIQI

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh Kimay
PRODUCTION Produzione Giacche

